

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7632 E diel 26 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Reporter.al"

Për legjionin e aktivistëve të të drejtave, ish-diplomatët, akademikët dhe të tjerëve që kundërshtojnë ashpër ndarjen etnike si një zgjidhje për mosmarrëveshjen ...
Vijon në faqen 21

Nga MARCUS TANNER

"Korrigjimi" i kufirit të Kosovës do të shkundothe themelet e Europës



Opinion i Ditës

Ekonomia jonë është e pagojë. Jo se ekonomistë të përgatitur, por argumentet e tyre nuk janë të forta, sa herë që flasin nga pozita partiake dhe politike. ...
Vijon në faqen 22

Nga FATOS ÇOÇOLI

"Protesta" e ekonomisë reale



Degjeneron konflikti mes dy vëllezërve
Sherri për 100 metra tokë, babai i katër fëmijëve goditet me sëpatë nga kushëriri

Sokol Lalaj: Kam 20 vite në Greqi, nuk do hakmerrem. Shteti duhet të bëjë drejtësi
Një konflikt pronësie për 100 metra tokë ullahte mund të përfundonte në tragjedi të vërtetë. Tre vëllezër dhe fëmijët e tyre, banorë të fshatit Çorrush të Mallakastrës, janë përfshirë në sherr me grushte deri në përdorimin e sëpatës. Nezir Lalaj (babai i Sokolit të plagosur), që ka në emër të tij 100 metrat tokë, tregon se konflikti nisi një ...
Në faqen 5

NDERTIMET INFORMALE/ PUBLIKOHET LISTA E FAMILJEVE QE MARRIN LEJET **LEGALIZIMET NE TIRANE, EMRAT E 1200 PERFITUESVE**

Procedura për certifikatën e pronësisë do të ndiqet nga ALUIZNI.
Sipërfaqja e legalizuar nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i ndërtimit



(Në foto) Ndërtime pa leje

Në faqen 7-11

TRAFIKU I DROGES
Kapen në Itali gjysmë ton hashash. Policia ndjek skafin, pranga 2 skafistëve
Në faqen 4

ORGANIZIMI
Maksimalizimi i votave, PS ngre grup pune për zgjedhjet vendore
Në faqen 3

PERPLASJA
Aksidenti me vdekje italianen, pranga shoferit në Sarandë
Në faqen 4

KULTURE
"Nuk i dua thinjat", Mehmet Myftiu boton poezitë e internimit
Në faqen 12

"NUK ZEVENDESUJME BE-NE"



Dyndje emigrantësh, Bushati: Jemi të gatshëm t'i japim një dorë Italisë
Në faqen 2

MILANO Gent Çoçoli për "Drejt Epsilonit të Eridanit" të Arion Hysenbegas

Romani i parë fantastiko-shkencor në shqip

Në brendësi: Ben Andoni, Fatos Kola, Jorgo Vaso dhe Preng Maca

Nga GENT ÇOÇOLI

Romani "Drejt Epsilonit të Eridanit", vepër e Arion Hysenbegas, është "i pari roman i mirëfilltë fantastiko-shkencor i letërsisë shqipe". Në botimin e tij të parë është pritur me dashuri, deri me entuziazëm nga lexuesit (i gjithë tirazhi përkatës u shit brenda një kohe fare të shkurtër). Për të janë dhënë vlerësime, kurse ribotimi i tanishëm (botimi i dytë) i jep lexuesit romanin në trajtën zanafillore, pa e prekur aspak dorëshkrimin ...
Suplement



DIPLOMACIA REFUGJATET

Ministri i Jashtëm: Dje Italia na shpëtoi, sot gati për të dhënë një dorë

Emigrantët e bllokuar, Bushati: Të gatshëm ta ndihmojmë Italinë

"Shqipëria nuk mund ta zëvendësojë Europën"

Valentina Madani

Shqipëria është e gatshme të ndihmojë Italinë fëmijë për të strehuar refugjatët e bllokuar në një anije në Itali. Tirana zyrtare i kujton Italisë ndihmën që u dha shqiptarëve vite më parë, ndaj sot i tregon se është e gatshme t'i japë një dorë për ta ndihmuar me refugjatët e bllokuar në anijen "Diciotti". Përmes një postimi në "Twitter", kryediplomati i Shqipërisë Ditmir Bushati shkruan në gjuhën italiane se Shqipëria nuk mund ta zëvendësojë Europën. "Ne nuk mund ta zëvendësojmë Evropën, por jemi gjithmonë këtu, në anën tjetër të një deti ku dikur ishim ata eritreas që po vuanin ditë e natë në mes të detit, duke pritur që Evropa të zgjohet. Dje Italia na shpëtoi. Sot, gati për të dhënë një dorë", shkruan Bushati. Reagimi i ministrit tonë të Jashtëm, vjen pas kërcënimit të fortë të qeverisë italiane përmes zëvendëskryeministrit vetëm dy ditë më parë, se do të bllokojë fondet për BE-në nëse vendet e tjera evropiane nuk marrin emigrantët. Konkretisht, Italia ka paralajmëruar se mund të ndërprerë fondet për Bashkimin Evropian, nëse shtetet e tjera nuk i marrin emigrantët që janë bllokuar në një anije që ka ankoruar në një port të Sicilisë, komente këto që Brukseli i cilëson si kërcënime. Të dërguarit nga shtetet e BE-së, që janë takuar në Bruksel më 24 gusht, kanë dështuar që të arrijnë një marrëveshje për ndarjen e përgjegjësisë për 150 emigrantët që gjenden në bordin e anijes "Diciotti", një anije e rojës bregdetare italiane, që është ankoruar në Katanja më 20 gusht. "Ne jemi të gatshëm të ndërpresim fondet që i japim Bashkimit Evropian, nëse blloku nuk merr përsipër problemin, të cilin nuk mund ta zgjidhim vetë", - tha zëvendëskryeministri italian, Luigi di Maio. Mbi 650 mijë emigrantë, shumica nga Afrika dhe Lindja e Mesme, kanë



Ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati

FALENDERIMI ITALIAN

Shqipëria ka vendosur të presë 20 emigrantë që kanë mbërritur në Itali. Ministri i Jashtëm, Enzo Moavero Milanesi falenderon Shqipërinë për vendimin për të pritur 20 emigrantë nga anija "Diciotti". Një sinjal i një solidariteti të madh dhe një miqësie të vlerësuar mjaft nga Italia — thuhet në një Tweet të Farnesina.

DITMIR BUSHATI

"Ne nuk mund ta zëvendësojmë Evropën, por jemi gjithmonë këtu, në anën tjetër të një deti ku dikur ishim ata eritreas që po vuanin ditë e natë në mes të detit, duke pritur që Evropa të zgjohet. Dje Italia na shpëtoi. Sot, gati për të dhënë një dorë", shkruan ministri Bushati.



Takimi

ILIR META

Presidenti Ilir Meta, gjatë vizitës së tij në Konispol takoi disa turistë italianë, të cilët kishin ardhur për turizëm në vendin tonë. Meta shkruan në "FB" se ishte i surprizuar me entuziazmin që turistët italianë kishin për vendin tonë. Ndërsa shton, se i ka inkurajuar ata që të forcojnë bashkëpunimin kulturor mes dy vendeve.

"Bego përfitoi 14 mln euro nga tenderat"

PD, akuza Markut: Po i shërben krimit sipas skenarit të Ramës

Partia Demokratike ngrii akuza të forta dhe ndaj Prokurorisë për rastin e Edmond Begos, biznesmenit që u ndalua pak ditë më parë nga autoritetet greke për shkak të një dënimi për trafik droge dhe një dënimi nga Italia në të kaluarën. Deputeti demokrat Luçiano Boçi akuzoi se "prokuroria po ndjek skenarin e Edi Ramës duke heshtur dhe duke mos nisur hetimet për Taulant Ballën, mikun e tij trafikant droge, dhe këdo që ka shkelur ligjin e prokurimit publik për të dhënë miliona euro punë publike një të dënuari si anëtar i organizatave kriminale". "Arrestimi 7 ditë më parë nga autoritetet greke i trafikantit të rrezikshëm të



drogës, Edmond Bego, nxori në dritë faktin tronditës se ai u shndërrua në biznesmen të fuqishëm ndërtimi, duke përfituar miliona euro nga buxheti i shtetit, pasi lidhi miqësi familjare me Taulant Ballën. Por qeveria dhe prokuroria kanë zgjedhur të heshtin përballë fakteve, në mënyrë që të

mbulojnë me harresë të vërtetën e përfitimt të miliona eurove nga një trafikant droge, në kundërshtim flagrant me ligjin e prokurimit publik. Prokuroria, e cila po provon çdo ditë se i shërben krimit të organizuar të lidhur me pushtetin, po ndjek skenarin e Edi Ramës, duke mos nisur hetimet për Taulant Ballën, mikun e tij trafikant droge, dhe këdo që ka shkelur ligjin dhe i ka dhënë atij miliona euro punë publike", - deklaroi Boçi. Sipas tij, prokuroria hesht, pa varësisht se PD-ja ka paratur fakte që provojnë shkeljen e ligjit, për t'i dhënë të paktën 14 milionë euro mikut me 5 emra të Taulant Ballës.

kaluar Detin Mesdhe për në Itali që prej vitit 2014 dhe Qeveria e re në Romë thotë se është zgjedhur pikërisht për të ndaluar rrjedhën e emigrantëve. Gjithashtu, Qeveria

italiane shprehet se nuk do të lejojë asnjë anije të ndihmës të zbarkojë pasagjerët e saj, nëse shtetet evropiane nuk pajtohen që t'i marrin dhe t'i strehojnë këta persona. Një

zëdhënës i Komisionit Evropian tha se "zgjidhja e çështjes së anijes "Diciotti" është prioritet, lere më kërcënimet, nuk do të na çojnë drejt zgjidhjes".



Kryemadhi thirrje për protesta

Marshi i LRI: Pas burmëshës të gjithë, piktori po na rrjep

Pas paralajmërimit të Kryetares së LSI-së, Monika Kryemadhi për fillimin e protestave në muajin shtator me mesazhin e fortë: "Duhet të ringjallim shpresën, po eliminohet popullsia shqiptare", LRI-ja ka nxjerrë edhe himnin e "betejës". Dje surprizuan të rinjtë e LRI-së. Që nga Jala, ku të rinjtë e Lëvizjes Rinore për Integrim ndodhen prej disa ditësh, kanë dërguar një përsëritje për të gjithë, duke mos harruar edhe kryeministrin Edi Rama, që në vargjet e këngës së tyre të titulluar "Marshi i rinisë", e quajnë "piktori i jeshiles". Të rinjtë përshkruajnë situatën në vend dhe i bëjnë thirrje popullit të ngrihet për të rrëzuar kryeministrin Rama. Në videon e postuar në rrjetet sociale dëgohet himni i ri, që ata e kanë quajtur "Marshi i rinisë shqiptare". Disa nga vargjet e marshit janë: "Çohuni djem e edhe vajza/ se rinia është e para/ mbas burmëshës shkoni të gjithë/ ta rrezojmë këtë qeveri. Shiten det e falen toka/ por Shqipëria është e jona". Videon e të rinjve të LRI-së ku këndojnë këngën e ka shpërndarë edhe Berisha, i cili shkruan: "Rinia do përmbysë narkoshtetin! Një shtator i tmerrshëm për Noriegën dhe narkoqeverinë e tij. Nderim të reja dhe të rinjve të vendit! Fitore!".



Dita e parë e takimit të kryeministrit Rama me ministrat e kabinetit të tij, e zhvilluar në qytetin e Vlorës, rezultoi dje me dy përfundime të rëndësishme: caktimin e datës së Asamblesë socialiste dhe konfirmimin e kandidatit për kryebashkiak të Tiranës në zgjedhjet e ardhshme lokale. Në këtë ditë të dytë të takimit, Rama bëri analizën parazgjedhore për Lokalet 2019. Mësohet se në mbledhje gjithashtu u diskutua për një strategji politike për komunikimin me publikun, dhe hartimin e një plani 1-vjeçar pune, ku do përcaktohen objektivat dhe performanca e qeverisë. Mbledhja e qeverisë në Vlorë, më shumë se një mbledhje qeverie pati tiparet e një mbledhjeje të PS-së, ku morën pjesë ministrat, por nuk munguan tre eksponentët e PS-së. Në përfundim të punimeve, kur u larguan ministrat, në takim mbetën Gramoz Ruçi, Taulant Balla, Bledi Çuçi dhe Erion Veliaj, duke dhënë kështu sinjalin e konfirmimit të kryetarit aktual bashkiak të kryeqytetit për një mandat të dytë. Mësohet se është vendosur krijimi i një grupi strategjik elektoral, me qëllim maksimizimin e votave në zgjedhjet lokale. Pjesë e grupit janë Blerina Gjylameti, Damian Gjijnuri, Ditmir Bushati, Bledi Çuçi, Taulant Balla, Erion Veliaj dhe Gramoz Ruçi. Grupi do të jetë përgjegjës për strategjinë elektorale dhe menaxhimin e aksionit elektoral.



Shehu: Strategji kombëtare kundër përdorimit të drogës

Deputeti demokrat Dritan Shehu, ish-ministër i Shëndetësisë, shprehet se ajo që po ndodh në vendin tonë me drogën është monstruoze e me pasojë shkatërruese për të ardhmen. Duke iu referuar shkrimit të "The Economist" që thoshte se Shqipëria është e para në botë për përdorimin e kokainës në raport me popullsinë, Shehu pyet se ku është kryeministri, që është edhe kreu i komitetit kombëtar kundër drogës e trafikëve. Ai deklaroi se përdorimi i kanabisit është ulur deri në moshat 11-13 vjeç, duke prekur rreth 70% të nxënësve në shumë qytete, por se nga ana tjetër mungon totalisht një strategji kombëtare për përbalimin e këtij fenomeni. "Shqipëria është kthyer jo vetëm në 'hambarin' e kanabisit për Evropën e 'autostradë' e trafikut të heroinës e kokainës, por dhe në një përdorues shumë të lartë të tyre sipas popullsisë", - tha z. Shehu.

VENDIMET
Pas mbledhjes së qeverisë, kryeministri Rama zhvilloi takime të veçanta për çështjet elektorale të PS-së. Të fundit që dolën ishin vetë kreu i Qeverisë, së bashku me kryeparlamentarin Ruçi dhe Sekretarin e Përgjithshëm të PS-së, Taulant Balla. Kjo treshe mësohet se ka vendosur që mbledhja e Asamblesë Kombëtare socialiste të zhvillohet të premtën e 7 shtatorit. Këtu pritët që Rama të zyrtarizojë vendimin nëse do të ndryshojë ekipin qeveritar, apo do të vijojë ende me të njëjtët njerëz. Burime nga takimi i Vlorës theksojnë se, Rama nuk ka treguar shenja që të bëjnë të mendosh

Vendimet në selinë qeveritare, Kryesia e PS më 3 shtator, Asambleja më 7 shtator

Maksimizimi i votave, PS në grup pune për zgjedhjet Në Vlorë merr pjesë edhe Veliaj



Gjatë një mbledhjeje të qeverisë 'Rama'

ZGJEDHJET
Mësohet se është vendosur krijimi i një grupi strategjik elektoral, me qëllim maksimizimin e votave në zgjedhjet lokale. Pjesë e grupit janë Blerina Gjylameti, Damian Gjijnuri, Ditmir Bushati, Bledi Çuçi, Taulant Balla, Erion Veliaj dhe Gramoz Ruçi. Grupi do të jetë përgjegjës për strategjinë elektorale dhe menaxhimin e aksionit elektoral.

"Këshilltari i kryeministrit: Plotësisht e vërtetë"

Paloka: Rama me çarter serb për ndeshjen Juventus-Lacio

Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka denoncoi dje, se kryeministri Edi Rama, pas mbledhjes me ministrat në Vlorë, ka mbërritur në Rinas me helikopter, e prej andej, me avion çarter është nisur drejt Torinos. Sipas Palokës, arsyeja e këtij nxitimi të Ramës është ndeshja Juventus-Lacio, që u zhvillua pasditen e djeshme në orën 18:00. "Pak minuta më parë, ekzaktësisht më 13:44, kryeministri i vendit më të varfër në Evropë, pasi ka mbërritur në aeroportin e Rinasit nga Vlora me helikopter 'Cougar', është nisur për në Torino me një çarter tip 'Cesna 550', të Serbisë YUBTB. Arsyeja: ndeshja Juventus-Lacio, që zhvillohet në orën 18:00. Kushdo që e ka mundësinë, gazetar ose jo, le ta verifikojë", shkruan z. Paloka. Pas këtij postimi, Drejtori i Komunikimit të kryeministrit Rama, Endri Fuga sqaroi për "Panorama": "Është plotësisht e vërtetë që kryeministri Edi Rama ka udhëtuar sot drejt Torinos, së bashku me Drejtorin Sportiv të Lacios, Igli Tare. Ata janë nisur nga Rinas me një avion të prenotuar nga klubi i Lacios për drejtorin sportiv, Igli Tare, i cili, pasi ka kaluar disa ditë pushime në jug të Shqipërisë, është kthyer në detyrën e tij".

dosur që mbledhja e Asamblesë Kombëtare socialiste të zhvillohet të premtën e 7 shtatorit. Këtu pritët që Rama të zyrtarizojë vendimin nëse do të ndryshojë ekipin qeveritar, apo do të vijojë ende me të njëjtët njerëz. Burime nga takimi i Vlorës theksojnë se, Rama nuk ka treguar shenja që të bëjnë të mendosh

se kryeministri anon nga ndryshimet, por kreu i Qeverisë së ka treguar shpesh se i pëlqen surprizat e momentit të fundit. Ndryshe nga e premtja, ku mbledhja ishte e fokusuar te mbyllja e analizës së ministrave, paraditja e së shtunës është fokusuar te çështjet zgjedhore dhe përgatitja e PS-së

"Mosndëshkimi, absurdi me drejtësinë"

Manjani: Gjithkund dënohen pushtetarët, këtu 'fajin e ka opozita'

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani shpreh shqetësimin që, ndryshe nga çfarë ndodh në vendet e tjera të botës ku dënohen pushtetarët, në Shqipëri sipas tij fajësohet opozita. "Sistemi i ndjekjes penale në Brazil, Malajzi, Pakistan, Korenë e Jugut e madje edhe në Kinë i heton, gjykon e dënon zyrtarët e lartë që kur janë në detyrë. Presidentë, kryeministra e ministra (pa përmendur nivelet e tjera) dënohen. I dënojnë pa qenë nevoja për SPAK, BKH, KLGJ, KLP, PPP, TTT, KKK, FFF, KNP, RMP, RTKT e tërë-mërr-mërr. I dënojnë pa u thënë asnjë fjalë të vetme Ambasada Amerikane. As u kërcet fare për të! I dënojnë gjatë kohës që janë në detyrë, jo thjesht kur bien nga fiku. Se kur bien nga fiku i dënojnë shumë shtete. I dënojnë për hiçgjë krahasuar me ç'bëjnë udhëheqësit tanë pro-amerikanë, pro-europianë, pro-përditë e pro-lindje, pro-lek e pro-valutë. Kudo ku ka sadopak kulturë shteti, pushteti ndëshkohet. Ndëshkohet ose me votë, ose me ligj, ose me të dyja bashkë! Kurse te ne ndëshkohet shteti dhe pushteti trashet si zullum. Dhe gjithmonë e për çdo gjë 'fajin e ka Opozita', - shprehet z. Manjani.

për garën e ardhshme elektorale. Në këtë sens, mësohet se në takim ka qenë i pranishëm edhe bashkëkryetari socialist i Reformës Zgjedhore, Bledi Çuçi, si dhe kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj, që qershorin e ardhshëm do të kërkojë një mandat të dytë. Kryeministri Edi Rama dhe ministrat e kabinetit

qeveritar përfunduan dje mbledhjen dyditore në rezidencën qeveritare në Vlorë, që i paraprarin nisjes së sesionit të ri politik. Kjo ishte mbledhja e fundit përpara se kryeministri të vendosë nëse do të ketë ndryshime në qeveri duke nisur nga shtatori apo do të konfirmohet besimi të ministrat aktualë.

Qafë-Thanë/ Makina del nga rruga, 3 të plagosur

Aksidenti për vdekje italianen, arrestohet 52-vjeçari në Sarandë

Pas aksidentit të rëndë në Sarandë ditën e djeshme, ku një grua humbi jetën dhe burri i saj u plagos, u arrestua shoferi që dyshohet si shkak i incidentit, Fatmir Rumani, 52 vjeç.

Policia ka bërë të mundur arrestimin e tij për ngjarjen e djeshme, ku konkretisht më datë 24.08.2018, në aksin rrugor Sarandë - Ksamil, në vendin e quajtur "Hidrovor", ky shtetas duke drejtuar automjetin tip "Ford" me targa AA 609 UD, është përplasur me motomjetin tip "Piaggio" me targa AL 429, me drejtues shtetasin italian



G.S., 63 vjeç, i cili ndodhet në Spitalin e Traumës Tiranë duke marrë mjekim më të specializuar. Si pasojë e kësaj përplasjeje ka humbur jetën shtetasja italiane M.S., 64 vjeçe, e cila ishte pasagjere në motomjet.

Materialet iu referuan Prokurorisë për veprën penale "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor", neni 290 i Kodit Penal.

Aksidentet kanë vijuar gjatë gjithë verës dhe ato nuk janë ndaluar as dhe.

Një aksidenti me pasojë plagosjen ka ndodhur dhe

në Librazhd. Incidenti ndodhi në aksin rrugor Qafë-Thanë - Librazhd.

Mjeti tip "Nissan" me targa HMB 2789, me drejtues shtetasin L.R., 41 vjeç, banues në lagjen "5 Maji" Elbasan, ka dalë nga rruga. Si pasojë është dëmtuar vetë drejtuesi i mjetit dhe pasagjerët (bashkëshortja dhe djali), shtetasja F.R., 41 vjeçe dhe fëmija O.R., 7 vjeç, banues në lagjen "5 Maji", Elbasan. Të dëmtuarit u transportuan për ndihmë mjekësore në spitalin e Përrenjasit, dhe ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e shkakut të aksidentit.

Operacioni i Guardia di Finanza, arrestohen dy shqiptarë që udhëtonin me gomone drejt Brindisit

Një operacion i madh i Guardia di Finanza në Adriatikun Jugor ka çuar në sekuestrimin e 553 kg drogë dhe arrestimin e dy shqiptarëve.

Operacioni është zhvilluar në mes të ditës, kur mjetet e GDF kanë lokalizuar në brigjet e Brindisit një gomone që nga ujërat ndërkombëtare po shkonte drejt bregdetit italian me një mbulesë që fshihte një ngarkesë të dyshimtë.

Kur financiarët e GDF arritën mjetin dhe i urdhëruan që të ndalonin, trafikantët rritën shpejtësinë për t'i shpëtuar kontrollit. Mjetet e shpejta të Departamentit të Operacioneve Aeronavale të Guardia di Finanza të Barit, pas një ndjekjeje të shkurtër, arritën të hipnin në gomone dhe të ndalonin garën.

Në bordin e saj u gjetën 26 pako me lëndë narkotike, konkretisht marijuanë. Mjeti i përdorur për trafikimin, një gomone 7 metra e gjatë, e adaptuar me një motor të jashtëm të fuqishëm, u sekuestrua nga Guardia di Finanza.

Skafistët shqiptarë, G.D., 46 vjeç dhe S.V., 38 vjeç, të dy nga Vlora, janë arrestuar për trafik ndërkombëtar droge.

Marijuana e sekuestruar nga Guardia di Finanza ishte futur në pako me madhësi të ndryshme, me një peshë totale prej 535 kg, e cila do të kishte dhënë pothuajse pesë milionë euro në tregun me pakicë.

Mediat italiane shkruajnë se edhe në këtë rast ka pasur bashkëpunim operativ dhe informativ me autoritetet e Policisë shqiptare, përmes njësive të Kufirit Detar të Guardia di Finanza të stacionuar në Durrës dhe Zyrës së ndërlidhjes Policore shqiptare në Itali.

Nga janari i këtij viti deri

Shqipëri-Itali, kapet gjysmë toni hashash

Ndjekja në det, pranga skafistëve nga Vlora. Otranto, "kanal droge"



në gusht, në rajonin e Pulas janë kapur në operacione të përbashkëta të policisë së vendit fqinj dhe asaj shqiptare 13 tonë hashash, në 12 ngarkesa.

Mediat italiane shkruajnë se janë arrestuar 31 skafistë, shumica prej tyre shqiptarë dhe një numër i vogël janë shtetas italianë. Ngarkesat variojnë nga 300 kilogramë në 1 ton.

Pavarësisht se në dy vitet e fundit, sipas statistikave të policisë kultivimi i kanabisit ka qenë thuajse zero, niveli i trafikut drejt Italisë rezultoi i lartë, raporton "Klan".

Droga e trafikuar besohet se është stoku i kanabisit të mbjellë gjatë viteve 2015-2016. Ngarkesa të konsiderueshme janë kapur edhe në Greqi. 3 tonë është

sasia e sekuestruar në kufirin me vendeve.

Shqipëria, sipas të dhënave të përditësuara të

"CIA FaktBook", vazhdon të jetë një ndër vendet më të rëndësishme nga ku furnizohet me lëndë narkotike

tregu evropian.

DRROGA E KAPUR NE GREQI

Një 34-vjeçar shqiptar është arrestuar në Igumenicë të Greqisë pasi iu gjet 86 kg kanabis në makinë. Lënda u zbulua të premtën me ndihmën e një qeni antidrogë. Droga ishte fshehur nën dyshemenë e makinës. Kanabisit ishte ndarë në pako dhe e vendosur poshtë ndenjësës së shofirit si dhe poshtë ndenjësës së përparme të pasagjerit.

Makina drejtohej nga 34-vjeçari shqiptar, identiteti i së cilit nuk është bërë ende i ditur.

Prangoset një prej autorëve, arriti të marrë një laptop

Grabitet dyqani i celularëve në Kuçovë, plagoset me thikë punëtori

Një grabitje ka ndodhur pasditen e djeshme në një dyqan celularësh në Kuçovë, ku ka mbetur i plagosur punonjësi. Policia ka arrestuar njërin prej autorëve.

Nga specialistët e Seksionit për Krimet u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit Klaudio Naska, 25 vjeç, banues në lagjen "1 Maji", Kuçovë, i dënuar më parë për veprat penale "Armëmbajtje pa leje" dhe "Kanosje". 25-vjeçari në lagjen "Llukan Prifti", në bashkëpunim me

një shtetas tjetër ende të paidentifikuar pasi ka goditur me mjet prerës (thikë) punëtorin e dyqanit, shtetasin E.I., 24 vjeç, kanë marrë 23 telefona celular dhe një laptop në dyqanin "Servis celularësh"

në pronësi të shtetasit G.D., 37 vjeç, banues në Kuçovë, dhe pasi kanë dalë nga dyqani, kanë thyer xhamin e parë të

automjetit tip "Benz" në pronësi të shtetasit E.I.

Ky i fundit ka njoftuar shërbimet e policisë, të cilët falë reagimit të shpejtë bënë të mundur identifikimin e njeriut prej autorëve dhe arrestimin e tij brenda një kohe të shkurtër.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan: 23 aparate ce-

PERPLASJA



Kundërshtuan me dhunë policinë, arrestohen 3 të rinj nga Vlora

Policia e Vlorës ka arrestuar tre të rinj dhe ka shpallur në kërkim shokun e tyre, pasi në bashkëpunim me njëritjetrin kanë kundërshtuar punonjësit e policisë të ushtrorë detyrën e tyre. Policia njofton se dhe u ndaluan shtetasit Olsi Hajno 26 vjeç, banues në Vlorë;

Aleko Rustemaj, 28 vjeç, banues në Vlorë; Henea Kamberaj, 30 vjeç, banues në Vlorë, si dhe u shpall në kërkim shtetas K.G.

Ndalimi i këtyre shtetasve u bë për ngjarjen e ndodhur më datë 23.08.2018, në vendin e quajtur "Kryqëzimi i Aleksandrisë", ku këta shtetas, në bashkëpunim me njëritjetrin, kanë kundërshtuar punonjësit e policisë duke i penguar ata të ushtrorë detyrën.

Materialet iu referuan Prokurorisë në ngarkim të këtyre shtetasve, për veprën penale "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 236 dhe 25 të Kodit Penal.

lularë të markave të ndryshme dhe një laptop. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat për veprat penale "Vjedhje me dhunë", "Plagosje e lehtë me dashje", "Shkatërrim prone", "Kanosje", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 139, 89, 150, 84 dhe 22 të Kodit Penal.

"Dora kullonte gjak", babai i 4 fëmijëve rrëfen sherrin: Shteti të ndërhyjë

Sherr për 100 m tokë, 39-vjeçari goditet me sëpatë nga kushëriri

Sokol Lalaj: Unë s'qëllova, me një dorë mbrohësia

Një konflikt pronësie për 100 metra tokë ullishte mund të përfundonte në tragjedi të vërtetë.

Tre vëllezër dhe fëmijët e tyre, banorë të fshatit Çorush të Mallakastrës, janë përfshirë në sherr me grush-te deri në përdorimin e sëpatës.

Nezir Lalaj (babai i Sokolit të plagosur), që ka në emër të tij 100 metrat tokë, tregon se konflikti nisi një vit më parë, kur pa se në certifikatë ai kishte më pak metra katrorë se i vëllai.

"Tokat i kemi në kufi me njëri-tjetrin. Në prill 2017 do nxirra tokën me certifikatë. Shoh se unë kisha më pak tokë në tapi dhe më thotë zyrtari që 'nuk mund të fusim këtë parcelë'. Çështja bllokohet. Komisioni i parë ia la tokën atij dhe i jep 100 metra atij. Komisioni i dytë më nxjerr mua 2900 metra katrorë, atij i nxjerr 2970 metra katrorë. Jemi në gjyq". Për 100 metra tokë, një konflikt që vazhdon prej vitesh mes vëllezërve mund të kishte përfunduar në tragjedi. Një 39-vjeçar, baba i 4 fëmijëve, është qëlluar me sëpatë nga kushëriri i tij, të cilit i kishin dhunuar babain. "Shteti të ndërhyjë", - thotë nga spitali Sokol Lalaj. Ai tregon gjithë ngjarjen dhe thotë se molla shërri është bërë një sipërfaqe prej 100 metrash ku ka mbjellë ullin, por se nuk po e zgjidh dot në mënyrë ligjore, raporton "News 24".

Shërrri ka ndodhur mes vëllezërve Lalaj në fshatin Çorush, ku policia ka arres-



tuar pas ngjarjes tre persona, mes tyre edhe 22-vjeçarin që plagosi kushëririn.

Për pronënjeni konfliktuar?

Nuk çaj dot në Mallakastrë se ka miq e ka shokë. Vete plaku e përzënë, vete unë, 'ik atje, ik këtu'. Kemi një vit e ca që sorollatemi, dhe për

çfarë, për tokën time! E sa është, 100 metra tokë, se mos janë hektarë, por unë e kam mbjellë me ullinjtë atë.

Jeni në proces gjyqësor?

Po, në proces gjyqësor: Se unë pardje erdha nga Greqia, Fieri e ka rrëzuar, nuk jam shumë i saktë. Unë jam emigrant në Greqi prej 20 vitesh, kam 4 fëmijë, 3 vajza

e 1 djalë. Dua ndihmë nga shteti. Kemi konflikt me tokat dhe vetëm shteti të vijë direkt të ndajë tokat. Se në komunë e bashki nuk çan dot, se ka njerëzit e tij.

Kush i ka tokat?

Ne jemi në konflikt me khaxhain për punë tokash. Të vijë shteti, me gjithë policinë e ministri çfarë janë, të

APELI NDAJ SHTETIT

Sokol Lalaj, djali që po merr mjekim në spitalin e Fierit pasi u godit me sëpatë nga djali i khaxhait, i kërkon shtetit të ndërhyjë për të parandaluar ndonjë tragjedi edhe më të rëndë.

Ai jeton në Greqi prej 20 vitesh dhe kishte vetëm pak ditë, të martën e kësaj jave, që kishte mbërritur në shtëpi për disa ditë pushime.

vijnë, që të mos bëhet gjendja më keq seç është.

Do merrni hak?

Jo, për t'u hakmarrë jo. Unë kam 4 fëmijë, nuk jam i tillë të hakmerrem. Dua në mënyrë ligjore.

Si ndodhi ngjarja?

Unë jetoj në Ballsh prej 10 vitesh, jam nga Çorushi. Dje kishte bërë llafë plaku

me khaxhain për punë e tokave dhe më merr byrazeri në telefon më thotë 'ik bëj denoncimin se khaxhai ka qëlluar babain'. Bëra denoncimin te policia, ika në shtëpi. Pas 5 minutash, dola prapë dhe po prisja që të vinin ata nga fshati me gjithë policinë dhe thashë të rrija atje. Pastaj u nisa të dilja lart, më vjen kushëriri shiziz me makinë, djali i khaxhait me sëpatë dhe filloi po më godiste, më ofendoi e më godiste. Në fillim filloi me bishtin e sëpatës, pastaj nuk e di si e ktheu dhe më zuri në dy vende, këtu. Në moment i bie sëpata nga bishti dhe ia futi vrapit, por policia ishte afër, 10-20 metra.

Po ti, e qëlllove?

Unë nuk e qëllova, me një dorë mbrohësia, siç më goditi mbaja dorën se kullonte gjak. Ai iku se i doli sëpata nga bishti e i doli policia përpara. E futën brenda, mua më çuan në spitalin e Ballshit me makinë policie, pastaj më sollën në Fier. M'i kanë qepur plagët.

Juxhin Çela në "Facebook": Ndjej se bëra aktin e duhur

Ndërhyri për të ndihmuar një grua, dhunohet me dorezë hekuri ish-nënkryetari i FRESSH

Juxhin Çela, ish-nënkryetar i Forumit Rinor Euro Socialist Shqiptar, e ka pësuar keq pasi ka ndërhyrë për të ndihmuar një grua.

Ka qenë vetë Çela që e ka treguar në profilin e tij në "Facebook", ndodhinë e një nate më parë. Ai thotë se autori ka qenë një i mitur, ndërsa shton se familjet nuk i edukojnë fëmijët në vlerat bazike për të jetuar në komunitet. "Dje pak para mesnate shikoj një grua në moshë që po konfliktohet me një grup të rinjsh të cilët e rrëzuan në tokë pas përplasjes verbale. Instinktivisht, sapa përballëm me këtë skenë për-



para meje, menjëherë vrapoj për të ndihmuar gruan në nevojë dhe ndarë palët e përfshira në konflikt, por një i mitur shqiptar aty kishte dorezë hekuri dhe më goditi. Ndjej se bëra aktin e duhur, përtej se familjet që nuk edukojnë fëmijët e tyre me vlerat bazike për të jetuar në komunitet janë një realitet

NDERHYRJA

"Instinktivisht, sapa përballëm me këtë skenë përpara meje, menjëherë vrapoj për të ndihmuar gruan në nevojë dhe ndarë palët e përfshira në konflikt, por një i mitur shqiptar aty kishte dorezë hekuri dhe më goditi", shkruan Çela në "FB".

dhe kjo do më sjellë 10 ditë regjim shtrati. Këtë sqarim e bëj për të shmangur telefonin e prishur", faleminderit kujtdo që më ka uruar shërim", shkruan Çela.

Organit të akuzës nuk i mjaftuan 10 muaj

Prokuroria heziton të çojë në gjykatë Saimir Tahirin

Hetimi ndaj ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri duket se do zgjasë edhe pas muajit tetor, kohë kur përfundon afati i hetimit. Prokuroria e Krimeve të Rënda pritet të kërkojë për herë të dytë kohë për të mbledhur prova kundër tij.

Disa prej prokurorëve të kësaj dosjeje kanë qenë në punë gjatë muajve gusht dhe shtator, pasi pritet që kjo kohë të jetë decizive për fatin e hetimit.

Hetuesit kanë administruar deri tani përgjigjet e letër-porositë të mbërritura nga Greqia dhe janë në pritje të informacioneve të dy letër-porositë të dërguara në Itali dhe një tjetër



në Mal të Zi.

Në këto dy vende Tahiri ka kryer disa lëvizje me disa nga personat që janë në të njëjtën dosje hetimore me të. Ndaj ish-ministrit prokuroria po zhvillon edhe një hetim pasuror, pas dyshimeve se

një pjesë e pasurisë së tij është produkt i aktiviteteve kriminale.

Deri tani, pas gati 10 muaj hetimesh nuk janë gjetur të ardhura të dyshimta. Llogaritë e tij bankare, të familjarëve dhe pasurisë e paluajtshme rezultojnë të justifikuar. Edhe për pjesën tjetër të personave që janë në hetim për trafik ndërkombëtar droge si pjesë e grupit të vëllezërve Habilaj nuk janë gjetur pasuri të pajustifikuar. Megjithatë, sipas "TV Klan" janë duke u kryer edhe disa veprime të tjera hetimore për të dalë në një konkluzion përfundimtar.

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me perbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 14.09.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III për shpëtimin e pasurisë të paluajtshme Truall me sipërfaqe 24.405,50 m² e ndodhur në rrugën "Ali Shëfqeti". Tiranë me Nr.pasurie:9/609, Volumi:20, Faqe:6. Në pronësi të Shoqërisë BAJU-CONSTRUCTION sh.p.k me vlerë fillestare në ankand 307.509 (Treqind e shtatë mijë e pesëqind e nente) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Perbarimore L.D.C

"Truall i ndertese", me nr pasurie 31/12, ZK 3428, vol 5, fq 3 me sipërfaqe totale trualli 1.837 m² dhe sipërfaqe ndertese 280 m² me adrese fshati Shtoj i Ri, Shkodër. Regjistruar me Z.V.R.P.P Shkodër në emër të Zako Spaso Ajković . Çmimi fillestar për shitje është 15.680.000 Leka. Data e shpalljes 26.07.2018 Data e zhvillimit 30.08.2018 deri në orën 16.00 Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Perbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 3/438+2-53, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 36, FAQE 37, SIPERFAQE 103 M2, ZONA KADASTRALE 8380, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ALBAN GEMAL BALA. ÇMIMI 8.700.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 24.09.2018 CEL. 0684026666 ; 0693262866.



Problemet me punësimin

Tregu, kërkesa për punë në “konflikt” me ofertën

Tregu i punës në vend paraqet probleme sa i përket kërkesës për punësim dhe ofertës së biznesëve, duke bërë që papunësia të jetë në nivele të larta. Shërbimi Kombëtar i Punësimin të ndjekje se

mospërputhja e ofertës dhe kërkesës për punë është e gjithanshme. Referuar shifrave zyrtare për vitin 2017, por që tregojnë thuajse të njëjtin trend edhe gjatë këtij viti, numri i ofertave për punë është 47.9% e numrit

të punëkërkuësve të papunë të regjistruar në të gjitha zyrat e punësimin, por nëse në qarqet Tiranë dhe Durrës kjo shifer shkon në 80%, në Qarqet Kukës dhe Dibër varion nga 9-13% të totalit të punëkërkuësve të papunë të

regjistruar. Nëse në kategoritë profesionale të zanatçinjeve, teknikëve të mesëm dhe specialistëve me arsim të lartë, oferta mbulon 40-100 % të kërkesave për punësim të atyre që janë të regjistruar, për profesionet elementare janë në dispozicion vetëm 7,314 vende të lira pune të regjistruara, ose 21.4% të totalit të kërkesave për punësim nga kjo kategori. Ndërsa nuk ka oferta fare për punëkërkuës të papunë pa profesion, që përbëjnë 8.6% të totalit të papunëve.

Autoriteti njofton qytetarët që nuk kanë marrë paratë për dëmet të depozitojnë kërkesat

Dëmet në aksidente, siguruesit paguan 13% më pak për 7-mujorin

Kompanitë kanë paguar 2.67 miliardë lekë dëmshpërblime

Dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve janë në rënie të ndjeshme këtë vit. Sipas të dhënave nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) i ka kërkuar në vazhdimësi Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BSHS) shpërndarjen e dosjeve për praktikant e miratuar, të paguara, të cilat kanë vendim gjyqësor të formës së prerë, objekt i Fondit të Kompensimit. Autoriteti njofton qytetarët që kanë problematika lidhur me dëmet të prapambetura nga Fondi i Kompensimit të komunikojnë me BSHS-në. Staf i Byrosë do t'i informojë dhe orientojë ata për shqërrinë e sigurimit tek e cila është deleguar praktika për kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit të tyre. Në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, lista e

ANKESAT

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) i ka kërkuar në vazhdimësi Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BSHS) shpërndarjen e dosjeve për praktikant e miratuar, të paguara, të cilat kanë vendim gjyqësor të formës së prerë, objekt i Fondit të Kompensimit. Staf i Byrosë do t'i informojë dhe orientojë ata për shqërrinë e sigurimit tek e cila është deleguar praktika për kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit të tyre. Në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, lista e



dosjeve nuk publikohet, por qytetarët e interesuar mund ta gjejnë informacionin e detajuar pranë BSHS-së.

“Për çdo problematikë apo për më shumë sqarime në lidhje me këtë proces, çdo qytetar mund të komunikojë

në email-in konsultim@amf.gov.al ose mund të paraqitet pranë zyrave të AMF-së. AMF-ja mbetet e angazhuar për mbrojtjen e konsumatorëve dhe rritjen e besimit të tyre në treg. Sikurse ka vepruar

për shumë vendimeve të marra gjatë viteve 2017-2018, AMF-ja vazhdon t'i kushtojë vëmendje mbrojtjes së interesave të qytetarëve. Autoriteti kërkon bashkëpunimin e qytetarëve që ata të kontaktojnë me AMF-në për çdo problematikë lidhur me tregjet nën mbikëqyrje”, thuhet në njoftimin e AMF-së.

VLERËSIMET

Sipas vlerësimeve, masa e Fondit të Kompensimit për detyrimet e mbartura dhe që do të lindin për vitin 2018 vlerësohet rreth 1.8 miliardë lekë, e ndarë: 1.25 miliardë lekë për ngjarjet nga viti 2001 deri 31.12.2013, ku përfshihen detyrimet të paguara, që janë në proces trajtimi apo proces gjyqësor pa vendim të formës së prerë; 418 milionë

lekë për ngjarjet nga viti 2014 deri në 31.12.2017, ku përfshihen detyrimet të paguara, që janë në proces trajtimi apo proces gjyqësor pa vendim të formës së prerë, dhe jo më pak se 150 milionë lekë për ngjarjet që mund të ndodhin gjatë vitit 2018. Bordi i AMF-së ka urdhëruar Byrosë Shqiptare të Sigurimit që të ndjekë procedurën e shlyerjes së menjëhershme të detyrimeve të paguara të praktikave të dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit, për të cilat ka përfunduar procesin e trajtimit (përbarmimor, me vendim gjykatë të formës së prerë dhe të miratuar, por të paguara) në vlerën totale 923 354 758 lekë për ngjarjet e sigurimit nga data 01.01.2001 deri në 31.12.2017.

Çmimi i shtëpive në Tiranë

Faktorë, sipërfaqja e zona, s'kanë rëndësi kati e ballkoni

Për herë të parë në Shqipëri është përdorur metoda hedonike për të vlerësuar faktorët që ndikojnë në çmimin e blerjes së apartamenteve. Metoda është aplikuar nga INSTAT-i dhe bazohet në vlerësimin e një serie karakteristیکash që ndikojnë në çmimin e apartamentit. Këto metoda çmimi matin peshën ose karakteristikat të caktuara si vendndodhja e banesës, numri i banjave, ose prania e karakteristikave të tjera në çmimin total të banesës. Variablat e përfshira në model janë: moshë apo viti i ndërtimit të banesës, numri i

dhomave, numri i dhomave të gjumit, numri i banjave, sipërfaqja në m², kati, ashensori, ballkoni si dhe minibashkitë ku ndodhen. Të dhënat janë mbledhur nga agjencitë imobiliare të kryeqytetit për vitin 2017-2018, duke qenë se analiza është bërë vetëm për tregun e apartamenteve në Tiranë. Në analizën e INSTAT-it ka rezultuar se statistikisht të rëndësishme janë: sipërfaqja në m², numri i dhomave të gjumit, moshë e ndërtesës ose viti i ndërtimit dhe shumica e variablave të minibashkive. Variablat e pavarur, që tregojnë efekt pozitiv në çmimin e banesave, janë:

madhësia, dhomat e gjumit, ashensori, banja, moshë dhe minibashkia 5. Përveç kësaj, variablat që tregojnë efekt negativ në çmim janë: kati, ballkoni dhe shumica e minibashkive. Ndërkaq, rezultati se niveli i katit nuk duket i rëndësishëm dhe tregon që familja shqiptare preferon të blejë apartamente në nivelet më të ulëta të ndërtesës. Në mënyrë të ngjashme, ballkoni i ndryshueshëm nuk është i rëndësishëm, sepse tregon që familja shqiptare duhet të jetë më e racionalë dhe të kërkojë më shumë hapësirë brenda apartamentit sesa ballkone.

KRIMET KUNDER PASURISE

Rriten vjedhjet e lokaleve dhe banesave, bie ‘shpërdorimi i detyrës’

Në tremujorin e dytë të vitit 2017 është evidentuar rritje e numrit të vjedhjeve të lokaleve të tregtisë dhe të banesave, ndërkohe që kanë shënuar ulje vjedhjet përmes shpërdorimit të detyrës. Të dhënat vijnë përmes Institutit të Statistikave. Në raportin mbi krimet kundër pasurisë INSTAT-i bën me dije se numri i veprave penale të evidentuara për vjedhje lokale tregtie, në tremujorin e dytë 2018, është 144, duke shënuar një rritje me 16.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i veprave penale të evidentu-

ara për vjedhje banese, në tremujorin e dytë 2018 është 304, duke shënuar një rritje me 14.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në këtë periudhë janë evidentuar 22 vjedhje duke shpërdoruar detyrën, 7 vjedhje më pak krahasuar me të njëjtin tremujor të 2017-ës. Ndërkaq, numri i veprave penale të rënda kundër pasurisë, në këtë tremujor është 23, duke shënuar një rënie me 11 vepra, krahasuar me tremujorin e dytë 2017. Kjo grupveprë përfshin veprat penale “vjedhje me dhunë”, “vjedhje me armë” dhe “vjedhje me pasojë vdekjen”.

Ornela Manjani

ALUIZNI publikon listën me 1200 pronarët që kanë gati lejen e legalizimit në qarkun Tiranë. Sipas ALUIZNI Tirana Rurale, të gjithë personat që gjejnë emrin në listat e afishuara duhet të paraqiten pranë Drejtorisë Laprakë për të tërhequr lejen. Bazuar te ndryshimet e fundit ligjore, qytetari duhet të marrë një kopje për të vërtetuar përmbartimin e procesit të legalizimit. Ndërsa, lidhur me procedurën vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ajo do të bëhet nga Agjencia.

TAPIA

Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesit të legalizimit, por gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të

Procedurat për certifikatën e pronësisë ndiqen nga Agjencia

ALUIZNI, 1200 qytetarët e Tiranës që përfitojnë lejen e legalizimit

Përfituesit në disa njësi dhe zonat përreth kryeqytetit



Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit, dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat, për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shpre-

hur më parë vullnetin, nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë, përveç pjesës takuese, edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përpulthet vullneti.

LISTA ME PËRFITUESIT, TIRANA RURALE

NR	EMER	ATESI	MBIEMER	KOMJUNA
1	SABRI	HAMZA	TARJA	BERZHITE
2	ALI	DERVISH	AGA	VAQARR
3	KUJTIM	QAZIM	SHIMA	FARKE
4	GENC	HAJDAR	ISUFI	DAJT
5	MYZEJEN,DOREL	ALI,RAMAZAN	HOXHA,HYSTUNA	FARKE
6	FIDAJE	HALIT	BAJRAKTARI	DAJT
7	SALI	SULEJMAN	HASANKOLLI	KASHAR
8	ILIAZ	LIMAN	BARDEHI	DAJT
9	GEZIM	VASIP	DEDA	KASHAR
10	XHEVAT	REXHEP	FERATI	VAQARR
11	ARJAN	OSMAN	SHERIA	FARKE
12	ASTRIT	BAJRAM	SEFERAJ	VAQARR
13	ERSEN	SHYQYRI	SHIMA	VAQARR
14	ALTIN	BESIM	XHEPA	ZALL-HERR
15	LULZIM	SELIM	TROKSI	DAJT
16	SEJDIR	SEJDIR	SELIMJA	VAQARR
17	SHERIF	FADIL	KULLLOLI	VAQARR
18	FLAMUR	ALI	DAITI	DAJT
19	ERIS	ARIF	PASMACIU	KASHAR
20	SHAZIVAR	ZEQIR	AGA	VAQARR
21	KOL	NIK	PALUSHI	ZALL-HERR
22	BLERIM	HAMIT	MIJA	PETRELE
23	SELMAN	OSMAN	RAMA	FARKE
24	LEONARD	KUJTIM	CULLHAJ	PETRELE
25	EUGLEN	BASHKIM	GJOKA	FARKE
26	SKENDER	SHEFOET	MALLIKU	VAQARR
27	ASLLAN	UK	DURISHTI	PETRELE
28	KALOSH	RASIM	KASAMI	FARKE
29	ILIA	AZEM	SENJA	KASHAR
30	ZARDIN	OSMAN	KORDHAKU	FARKE
31	FERDINANT	PULLUMB	CELANJ	KASHAR
32	ELVIN	ZYHDI	KERCIKU	PETRELE
33	ARIF	MERSIN	MICI	KASHAR
34	SHKELQIM	JEMIN	SALLA	BERZHITE
35	SAMI	AQIF	META	ZALL-HERR
36	INDRIT	QEMAL	GJOKA	KASHAR
37	NIJAZI	REXHEP	UKUJ	PETRELE
38	GEZIM	MAHMUT	SEFA	VAQARR
39	RESMIJE	HARIZ	SHEHU	VAQARR
40	XHEMAL	HASAN	LOZI	ZALL-HERR
41	ROLAND	AGIM	MEHIDRI	DAJT
42	LUFTI	RRAP	BALA	FARKE
43	ARDIAN	SHEFOET	MOLLAJ	VAQARR

44	MEHMET	SHABAN	HAKA	FARKE
45	FATBARDHA,KLA	BAJRAM,HAKI	LLOCI	FARKE
46	BUJAR	JONUZ	BEQARI	PETRELE
Autori rrëfen në këtë intervistë zhanrin e tij të preferuar dhe jo vetëm. "Drejt Epsilonit të Eridanit" tregon me një gjuhë të pasur e të pastër shqipe, me art e duke u mbështetur mirë në të vërtetën shkencore, një udhëtim tërheqës, plot ngjarje të larmishme me ngjyra të gjalla (që romani i vendos në shek. XXVI), përmes oqeanit galaktik. Është një anije kozmike fotonike (pra, që arrin të lundrojë me shpejtësi të afërt me atë të dritës dhe romani tregon edhe ndërtimin e saj) me një ekipazh kozmonautësh të sprovuar e të guximshëm në bord, e cila përshkon hapësira të pamata kozmike, kapërcen vështirësi madhore, përballat me rreziqe të thikta, kryen zbulime të vryra befasuese, grumbullon thesare për dijen tokësore e nuk i ndahet synimit themelor: arritjes së një planeti që sillet rrotull yllit Epsilon të yllsisë së Eridanit.

Jeni i pari shkrimtar shqiptar që keni shkruar një roman fantastiko-shkencor. Përse ju tërhoqi ky zhanër?

"Për të qenë të përpiktë, duhet të pohojmë se romani fantastiko-shkencor "Drejt Epsilonit të Eridanit" është i pari roman i mirëfilltë fantastiko-shkencor për të rritur i letërsisë shqipe, por, edhe para botimit të tij ka pasur shkrime fantastiko-shkencore për fëmijë me autorë shqiptarë.

Për mua është mëse e natyrshme që të më tërhiqte, madje të më joshte, të më frymëzonte letërsia fantastiko-shkencore: Vë në dukje se, në vitin akademik 1963-64 kam mbaruar studimet e rregullta dhe jam diplomuar në Degën e Matematikës, të Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe më pas, me përjashtim të viteve 1975-1981, kur, në kushtet e forcimit të Luftës së Klavave u detyrova të punoja në një fshat malor, gjatë gjithë kohës kam dhënë mësim në lëndët matematikë, astronomi e informatikë në shkolla të mesme, në Institutin e Lartë "Aleksander Xhuvani" dhe në Universitetin Politeknik të Tiranës. Nga ana tjetër, dashuria për letërsinë më është ushqyer nga prindërit që në moshën time të vogël".

Ju e keni shkruar "Drejt Epsilonit të Eridanit" në vitin 1979, ndërkohe që Lufta e Ftohtë vazhonte të ishte prezente për të gjithë popujt e botes, duke përfshirë Shqipërinë e vetëzokulor (por vetëm në kuptimin e ngushtë të fjalës). Gjatë shkrimit të romanit, a jeni ndikuar sadopak nga gara për "zotërimin" e kozmosit midis dy superfuqive të kohës, pra SHBA dhe BRSS?

"Romani shtjellon ngjarje që i sheh në një kohë të ardhme, kur njerëzit në Tokë jetojnë ashtu si do duhej, siç dëshirojmë me të madhe të gjithë, të jetohej edhe në ditët tona. Pa pasur asnjë prirje politike, pa dashur të ndikohet nga luftërat midis fuqive të ndryshme aq të zakonshme në botën e djeshme e të sotme, romani e mendon botën e të ardhmes të çliruar nga interesat e



Arion Hysenbegas

ngushta të shtypjes, skllavërimin, marrjes nëpër këmbë të të drejtave elementare të të tjerëve për të nxjerrë përfitime vetjake. Luftat, përpjekjet e pangopura për zgjerimin e sundimeve dhe edhe gara për "zotërimin e kozmosit", siç e quani ju, nuk kanë ndikuar aspak në shkrimin e romanit. Për "Drejt Epsilonit të Eridanit" ato i përkasin të shkuarës, personazhet jetojnë jetën e tyre, ndeshen me të papritura të rrezikshme që duhet t'i përballojnë, kryejnë zbulime interesante të vryra për dijen tokësore; megjithatë, tërthorazi, romani shpall se bota e nesërme do të jetë një sendëzim i shpresave të sotme për të mirë, se e shëmtuara që errëson ditët tona do të jetë e vdekur nesër; DHE kështu, i jep lexuesit një mesazh".

Në romanin tuaj, eksplorimi i kozmosit, dhe vetë zhanri i fanta-shkencës, lldhen me një imagjnatë që është në thelb utopike. Në fakt, edhe në propagandën zyrtare të SHBA dhe BRSS gjatë kulmit të garës për "zotërimin" e kozmosit, kjo e fundit është paraqitur gjithnjë në termat e progresit të vazhdueshëm e të paevitueshëm të njerëzimit. Por, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, e sidomos në Shtetet e Bashkuara, eksplorimi i kozmosit, dhe veçanërisht zbulimi i qenieve jashtëtokësore, lidhet me një imagjnatë që është në thelb distopike. Përse mendoni se ka ndodhur kjo?

"Për bindjen time, eksplorimi i kozmosit është një nevojë jetike për njeriun e Tokës dhe letërsia e mirëfilltë fantastiko-shkencore tregon me fantazi të mbështetur detyrimisht në të vërtetën shkencore të njohura apo ende të parajtura si hipoteza të mundshme po nga shkenca. Le të flasim mirë për romanin "Drejt Epsilonit të Eridanit: Toka nuk është e përjetshme. Një mori



ARION HYSENBEGAS
Duke shpresuar për një ditë të mirë

dukurish natyrore rrezikojnë jetëgjatësinë e saj. As vetë Dielli nuk është i përjetshëm, edhe atë e kërcënojnë dukuri vrasëse të njohura që prej shumë kohe nga astrofizika. Edhe sikur të hamendësojmë se gjithçka te ai e rrethanimi i afërt me të do të vazhdojë të jetë krahasimisht "e qetë" si sot, Dielli është një yll i verdhë, i madhësisë mesatare dhe, për më tepër, drejt plakjes. Dihet se e ardhmja e tij do të jetë e pashmangshme: Rezerva energjike e Diellit nuk është e pafundme. Ajo do të pakësohet, po pakësohet me kalimin e kohës dhe "ylli tonë jetëdhënës", Dielli do të ftohet shkallë-shkallë, do të shndërrohet paralelisht në një gjigant të kuq, do të përfshijë brenda vetes fillimisht planetet e afërt, Merkurin, Afërditën e, menjëherë më pas Tokën dhe...

Njeriu duhet të gjejë në rrethanimin e afërt kozmik, një vendbanim të ri, ku të mbartet për të mundur të mbijetojë. Është një nevojë madhore kjo, një nevojë e njohur që mjaft kohë më parë. Në Tokë janë ndërtuar sy e veshë të fuqishëm që vrojojnë vazhdimisht hapësirën e gjerë qiellore, që rreken veçanërisht të kapin shenja artificiale të ardhura nga diku, të zbulojnë kështu se në një trup të caktuar qiellor ka jetë, jetojnë qenie të arsyeshme.

Në romanin "Drejt Epsilonit të Eridanit" tregohet se në Tokë arrin një radiosinjall, që, pasi ç'kodohet me mundim, mësohet se është nisur nga një planet që sillet rrotull yllit Epsilon të yllsisë së Eridanit. Ngjarjet e romanit zhvillohen në një kohë kur dija e teknologjitë kanë evoluar në Tokë deri në atë shkallë që ka bërë të mundur që të jetë ndërtuar anija fotonike, anije kozmike që mund të lundrojë me shpejtësi të afërt me shpejtësinë e dritës. Dhe kështu njeriu, një ekipazh i zgjedhur

kozmonautësh nisat drejt Epsilonit të Eridanit me anijen fotonike "Kometa III". Është, pa dyshim, një ngjarje e madhe. Epsiloni i Eridanit gjendet 11 vjet-dritë larg Tokës. Anijes kozmike i duhet të përshkojë detra të gjerë të Galaktikës, të kapërcëjë dukuri natyrore sulmuese, të gati verbohët nga "Efekti Doppler", të përpiqet të mos i largohet trajektore së duhur dhe ekipazhi përballat me vështirësi të ndryshme deri tepër të rrezikshme, jeton ngjarje të papritura, kreyt të mundëshme për kushtet mes të cilëve gjendet dhe, mjaft interesante për lexuesin, kryen edhe mjaft zbulime të rëndësishme për dijen, për kërkimin shkencor...".

Morët vendimin për t'a ribotuar "Drejt Epsilonit të Eridanit" për t'i ofruar lexuesit dorëshkrimin origjinal të librit, i cili pësoi disa ndryshime në botimin e parë. A ka ndonjë arsye tjetër pse ju e ndjetë të nevojshme t'a ribotoni romanin që lidhet më ngushtësisht me kontekstin historik aktual?

"Bashkë me time shoqe, ndonjëherë bashkë edhe me nipërit e mij, unë vij në Tiranë, dhe kaloj rreth dy muaj në Shqipëri me time. Disa nga miqtë e mij të vjetër, madje, mes tyre, edhe disa të njohur të rinj, m'u lutën që të bëja të ribotohej romani "Drejt Epsilonit të Eridanit", që ishte pritur shumë mirë nga lexuesit dhe ata nuk e harronin. Nuk desha t'ua prishja. Ata më kërkuan, po ashtu, që romani të botohej në trajtën fillimtare, ashtu si që dorëzuar në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri". Për fat, unë e kisha dorëshkrimin zanafillor dhe ky botimi i dytë i "Drejt Epsilonit të Eridanit" është botimi i parë i plotë i tij".

Zhvillimet e mëdha teknologjike dhe zbulimet e vazhdueshme astronomike sa i kanë ndikuar artet e sidomos letërsinë?

"Pyetja që po më drejtoni kërkon një përgjigje të gjerë, por unë e quaj të udhës të përsëris pohimin e thjeshtë, që besoj është i vërtetë për gjithkënd: Artet e veçanërisht letërsia kanë evoluar gjithmonë paralelisht me kohën, me shtimin e dijës, pasurimin e mendimit, e kuptimeve, e vetë bukurive shpirtërore që shihen nën drita të larme, ndoshta më të forta, paralelisht me zgjerimin dhe tërësinë e ndryshimeve përkatëse të jetës. Natyrisht, edhe sot, vërehet e njëjta dukuri, madje ndikimi i drejtpërdrejt dhe ai i tërthorë i teknologjive të sotme dhe zbulimeve të mëdha në fusha të ndryshme të dijës, vërehet i shtrirë mjaft gjerë, vërehet në lindjen e rrymave të reja artistike, në gjetjen e mjeteve të reja shprehëse në art, në provat, në përpjekjet (ndonjëherë kreyt të cartura) për të shprehur lirish shpërthime frymëzimesh të veta".

I IDE

NGA BEN ANDONI

Komunizmin paradoksal shqiptar, mung esën e vlerësimit të pastër ndaj tij, ashtu si vepruan edhe regjimet përpara tij, vazhdon të rrëfejë handikapin real të pasqyrimin të gabuar të paraardhësve. Kompleksi i zakonshëm dhe konjunkturatur (lexo: përfitimet) i kanë bërë shumë njerëz, që në kohën e ekzistencës së shtetit shqiptar, të ngacmonin dhe të hidhnin poshtë çdo gjë arritur nga paraardhësit, ashtu si do bënin në kohën e Mbretërisë dhe Fashizmit. Kohë më vonë komunistët do të fshinin gjithçka para tyre duke na lënë vetëm një vit dhe krahasim me të shkuarën. Ishte viti 1938, që shumë nga shqiptarët ende sot nuk e dinë pse i referoheshin komunistët, i cili bënte kohën krahasimtare ku bazonin ndryshimin e tyre.

Në kohën tonë është rikthyer ose më saktë rikthehet komunizmi sa herë që politika do të shmangë vëmendjen nga problemet e saj. Është e vërtetë që një iniciativë përpjekje që të vendosë një lloj rregulli në përbashkëtimin e filmave dhe librave, por që megjithë përpjekjen vazhdimisht bllokohet prej futjes së lloj-lloj mendimeve dhe konfrontimeve. Në fakt, është e habitshme sesi sot ende jepen mirëfilli materiale propagandistike të së shkuarës, që më shumë sesa glorifikim i asaj kohe i përshfaq absurd në qëllimet e tyre njësitë emetuese ose botuese. Ose më saktë tregon një kompleks qesharak,

Në kohën tonë është rikthyer ose më saktë rikthehet komunizmi sa herë që politika do të shmangë vëmendjen nga problemet e saj. Është e vërtetë që një iniciativë përpjekje që të vendosë një lloj rregulli në përbashkëtimin e filmave dhe librave, por që megjithë përpjekjen vazhdimisht bllokohet prej futjes së lloj-lloj mendimeve dhe konfrontimeve. Në fakt, është e habitshme sesi sot ende jepen mirëfilli materiale propagandistike të së shkuarës, që më shumë sesa glorifikim i asaj kohe i përshfaq absurd në qëllimet e tyre njësitë emetuese ose botuese.



që duhet thënë se pjesa më e madhe e popullit ia ka dhënë dërrmën me kohë. Në fakt, nuk është tërësisht faji i një pjese të kineastëve tanë, që megjithëse kanë prodhuar dhe shërbyer nën kanonet e Realizimit Socialist dhe në fakt nuk kishin sesi të devijonin, kanë prodhuar segmente me vlerë në filmat e tyre. Më qesharak bëhen vetë këta të fundit kur përpigjen t'i mohojnë filmat, apo një pjesë e tyre syresh kanë luftuar shumë t'u njiheshin të drejtat e autorit, në një kohë që kjo e drejtë prevalonte në të drejtën e shtetit dhe si thuhet nga propaganda, shteti ishte i punëtorëve dhe fshatarëve. Madje i sanksionuar edhe me kushtetutë.

Në deбатin e sotëm dhe seriozitetin e tij duhet të ketë një dimension real moral dhe ai ka të bëjë me faktin, që publiku realisht nuk mund të mbytet më me bëmat e Bllokut, protokollet e pleniumeve të lodhshme dhe pa sens sot, apo me dokumentarë mirëfilli lejfenistë (këto mund t'i shërbejnë shumë mirë studiuesve). Njësoj, si editorët e gazetave kryesorë në vend duhet ta kenë si moto shmangien e tyre, përmbi përpjekjen meskine për të përfutur.

Ndërkohë që përpjekja për ta institucionalizuar iniciativën dhe

për të penguar botime mund të kthehet në një bumerang për të kërshtuar njerëzit për t'u rikthyer në një formë tjetër botimeve, këtyre filmave e kështu me radhë për të zbuluar një gjë që sot është krejt pa logjikë. Ajo më shumë bën qesharakë ata që vazhdojnë e i botojnë dhe emetojnë shumë gjëra që lidhen me diktatorin dhe komunizmin.

Paradoksi është se në kohën tonë, populli shqiptar ia ka vendosur vulën komunizmit dhe është ndarë realisht me të. Paçka zhgënjimit të frikshëm me sistemin në fuqi sot dhe varferinë e madhe, largimin e njerëzve për çdo ditë nga vendi dhe më shumë akoma humbjen e shprehës, komunizmi e ka marrë notën e tij pakaluese dhe mbi të gjitha indiferencën. Insistimi për ta risjellë këtë gërdallë duket më shumë si mundësi për të përfutur.

... Komunizmi ndërtoi një kompleks idesh (të një bote të re superiore ndaj kapitalizmit) me pushtetin (monopolin e qeverisë mbi politikën dhe ekonominë) – që përbënte një lloj amalgamë e cila ndikoi sidomos te modeli për të mëkëmbur shqiptarët e varfër. Por ndërsa në Vendet Lindore komu-

nizmi u shpërbë dhe u modifikua këtu u zhvillua ashtu si po zhvillohet kapitalizmi i sotëm plot me paradokse. Nuk duhet harruar se idetë e komunizmit e dominuan historinë e shekullit të njëzetë dhe u besua se ky sistem do të sillte një lloj barazie mes njerëzish. Ai korpus veprash në art dhe ajo demagogji për ta mbajtur atë sot mund të qëmtohet, por kurrsesi nuk mund të mbushet me mballo-ma dhe footnota, sepse përndryshe do të shtohen spekulantët që mezi presin të përfutojnë. Ndërkohë që ka hapësirë pa fund për të bërë atë që bëri Solzhenicini, Grass apo Cezlav Milosio...për realitetet e vendeve të tyre.

Hannah Arendt prodhoi një përshfaqje origjinale dhe u mundua që bashkëkohëse t'u kumtonin të vërtetë në sy, por duke e lidhur diktaturën naziste me atë sovjetike në faktin e ardhjes së shoqërisë masive dhe formave të reja organizative. Në fakt, edhe ajo hasi në moskuptime nga bashkëkohësit për idetë dhe mënyrën sesi e pa totalitarizmin. Por edhe vetë komunizmi duket tej i ndarë dhe krejt pa logjikë krijuese, kështu në librat e tij Zbigniew Brzezinski e vuiri më së miri në dukje këtë kur rrëfeu dallimet ndërmjet

Bashkimit Sovjetik dhe satelitëve të tij në Evropën Lindore. Ashtu si studiues të tjerë panë shumë paradokse deri në aleancat e shteteve të Majta si ajo Kino-Sovjetike, duke treguar se Moskë dhe Pekini ishin të ndarë jo vetëm nga interesa të ndryshme kombëtare, por edhe nga ajo që i lidhte në një ideologji e përbashkët. Po Shqipëria? Një vend që e importoi komunizmin dhe që kaloi fazat për zhvillimin e tij, duke menduar deri se e ndërtoi është realisht me probleme. Dhe, më shumë duken sot, ata që mudohehen ta ngjallin me çdo lloj mënyre.

... Me pak fjalë, komunizmi ka vend për t'u studiuar për të zbuluar paradokset tona sepse performoi në një kohë, që duam apo nuk duam i dha impulse vendit, shkollë shqiptarë, ndau një pjesë jo të vogël të njerëzve dhe i bëri ata të mendonin realisht, ndërkohë që studimet tona më të mëdha duhet të shkojnë realisht në faktin sepse shqiptari nuk prodhon një regjim që të rrisë mirëqenien e tij, mu në këtë mrekulli tokësore që i ka kaluar natyra. Ky është problemi, kurse sa i përket komunizmit, ai duket se do të mbetet një mjet thjesht për të përfutur, siç ndodh jo pak herë.

MBI ROMANIN “DREJT EPSILONIT TË ERIDANIT”

Romani “Drejt Epsilonit të Eridanit”, vepër e z. Arion Hysenbegas, është “i pari roman i mirëfilltë fantastiko-shkencor i letërsisë shqipe”. Në botimin e tij të parë është pritur me dashuri, deri me entuziazëm nga lexuesit (i gjithë tirazhi përkatës u shit brenda një kohe fare të shkurtër). Për të janë dhanë vlerësime të larta plotësisht të merituar dhe autorin e përgëzuan me të madhe miqtë, të njohurit, dashamirët. Ribotimi i sotëm (botimi i dytë) i jep lexuesit romanin në trajtën zanafillore, pa e prekur aspak dorëshkrimin e vet fletastar; është, pra, botimi i parë i plotë.

“Drejt Epsilonit të Eridanit” tregon me një gjuhë të pasur e të pastër shqipe, me art e duke u mbështetur mirë në të vërtetë shkencore, një udhëtim tërëheqës, plot ngjarje të larmishme me ngjyra të gjalla (që romani i ven-

dos në shek. XXVI), përmes oqeanit galaktik. Është një anije kozmike fotonike (pra, që arrin të lundrojë me shpejtësi të afërt me atë të dritës dhe romani tregon edhe ndërtimin e saj) me një ekuipazh kozmonautësh të sprovuar e të guximshëm në bord, e cila përshkon hapësirë të pamata kozmike, kapërcen vështirësi madhore, përballet me rreziqe të thikta, kryen zbulime të vlera befasuese, grumbullon thesare për dijen tokësore e nuk i ndahet synimit themelor: arritjes së një planeti që sillet rrotull yllit Epsilon të vllësisë së Eridanit. Nga ai planet, tregon romani, i janë dërguar Tokës radiosinjale të shumëpritura, të dëshiruara ndër shekuj, të kërkuara po qysh prej mjaft shekujsh më parë.

Dihet që Toka nuk është e përjetshme: Dukuri të shumta natyrore shkatërrimtare mund ta sulmojnë rëndë planetin tonë nënë. Dihet, po ashtu, që vetë Di-



elli, “Zoti i jetës” në Tokë, nuk është i përjetshëm. Ai mund të vazhdojë të ndriçojë, të ngruhë, të

udhëheqë sistemin tonë diellor edhe për vetëm disa miliona vjet (natyrisht, në qoftë se do t'u shpëtojë të papriturave kozmike dhe jeta e tij do të vazhdojë të mos goditet nga dukuri shkatërrimtare, gjë që nuk mund të jetë e sigurt): Dielli, një yll i verdhë, i madhësisë masatare, nuk ka rezervë të pafundme energjie.

Këto të vërteta, njihen nga shkencë (kryesisht nga astronomia, nga astrofizika) dhe qysh prej shumë kohe, njerëzimi ka ëndërruar për të hasur jetë, qenie të arsyeshme botë planetare jashtëtokësore me kushte të përshatshme për jetën mbi bazën e karbonit, të ngjashme me kushtet e Tokës sonë, apo thjesht të përafërta me to e të pranueshme për gjallesat tokësore. Shkencë pohan se Toka nuk mund të jetë i vetmi planet në Gjithësi, madje në Galaktikë, ku të ketë jetë. Veçanërisht në shekullin XX, Toka ka bërë përpjekje të drejt-

përdrejta dhe vazhdon edhe sot të bëjë me këmbëngulje përpjekje për të zbuluar planetë të banuar nga qenie të arsyeshme, duke shpresuar të lidhet me to, të miqësohet deri të vëllazërohet. Ky kërkim i shërben pa dyshim dijes, por njëkohësisht, ka rëndësi jetike për njerëzimin, krijon përparësi për të ngadhënjyer mbi kohën, për të siguruar mbijetesën e njeriut përballë kërcënimeve madhore të pashmangshme natyrore. ... Romani “Drejt Epsilonit të Eridanit” tregon një arritje të kësaj ëndrre e shprese të pasuar të njerëzimit dhe të bën ta besosh të vërtetë duke të endur njëkohësisht mes ngjarshes rrëmbënjëse, takimesh befasuese, pleksje forcash, vështirësish, rrethanash deri fantastike; duke paraqitur botën kozmike të gjallë, gjithë lëvizje, të shumëngjyrshme, të populluar nga trajta të panumërta lëndore që u nënshtrohen një morie dukurish.

P

PERSONAZH

Artikulli botohet në nderim të krijuesit dhe kritikut të njohur që këtë muaj i përkohet datat e lindjes dhe ndarjes nga jeta. Autori me pak panegjirizëm na tregon një njeri që ka kontribuar shumë në letrat shqipe, por edhe që ka qenë shumë i mënjanuar nga bashkëkohësit

Rinush Idrizi, ëndërr e vrarë

Homazh për poetin dhe studiuesin e shquar në 80-vjetorin e lindjes dhe 10-vjetorin e ndarjes nga jeta

NGA FATOS KOLA

Poeti dhe studiuesi Rinush Idrizi lindi 80 vjet më parë, më 14 gusht 1938. U nda nga jeta bash në vlagën e krijimtarisë letrare e studimore, në pjekurinë e plotë, në vetëpërbajtjen emotive të vrullit të kahershëm poetik, inkandeshencës pedagogjike dhe thellësisë së gjykimit prej burri të mocëm, të cilit i mungonte më i pakompensueshmi mallëtim: atdheu dhe dashuria e pashuar për të, atje në Amerikën e largët.

Gjithë jetën e tij të gjatë krijuese shkroi poezi, studioi poetikën madhore të kolosëve të letrave shqipe si Mjeda (Mjedja), Migjeni dhe Poradeci. Krijoi dhe konsolidoi kultet, idolatrinë, hierarkinë dhe panteonin vetjak të letrave. Adhuroi dhe dashuroi pafund. U nda nga jeta larg atdheut, shokëve e miqve, teksa përpinte thagmën dhe ohet e pambarimta të kolegëve poetë të mbarë planetit, duke peshuar me kandarin e studiuesit dhe gjykesit të pakompromistë gjithçka prekte, lexonte e studioje.

Kreu studimet në fakultetin Histori-filologji (dega Gjuhë Letërsi), në vitet 1958-1962. Për shkak të cilësive dhe talentit të spikatur e emëruan si mësues letërsie në gjimnazin "Sami Frashëri", ku jetësoi ëndërrin e tij për të kultivuar tek nxënësit dashurinë për letërsinë shqipe, për korifejtë rilindas dhe jetën që ata frymëzojnë e motivojnë. Gjithçka në gjurmët e nënës së tij, gjithashtu mësuese e shquar.

Si mësues la gjurmë të thella në mendjet dhe zemrat e nxënësve të tij që e adhuronin asokohe, sikurse edhe sot, teksa me punën plot përkushtim e profesionalizëm skaliti personalitetin e tyre dhe u vulosi pasionin për letrat dhe gjuhën e bekuar shqipe. Për të nxënësit e tij ishin gjithçka, ndaj dhe u kushtonte gjysmën e ditës së Zotit, paraditen e deri mbasditen e vonë. Gjithçka që Rinush Idrizi bënte dhe thoshte në shkollë e jashtë saj, përmbajte nga pasioni dhe dashuria për vlerat e mëdha njerëzore e krijuese.

Ai shpërtheu në kritikën letrare të kohës me kompetencën, inteligjencën dhe pjekurinë e një njohësi, vëzhguesi dhe vlerësuesi të ditur e të drejtë. Përbuzte klishetë dhe qiçet në krijimtarinë letrare, pasoja këto të konformizmit, mungesës së kulturës, shablonizimit shpërbljes të mediokritetit dhe varfërisë metodologjike të zhdanovizmit të imponuar. Natyrshëm kultivoi dhe rriti frymën kritike dhe antikonformizmin në krijimtarinë dhe studimet letrare, çka ra në sy të vijërojtësve censurë, që e ndëshkuan bash në kulmin e fushatës që shpërtheu pas Plenumit IV të PPSH në vitin 1973.



Rinush Idrizi

E emëruan në një fshat të largët të Shëngjergjit, nga ku mund të vinte pranë familjes vetëm në fundjavë. Atje qëndroi deri në fundvitet '80, për t'u afruar pranë familjes vetëm vitet e fundit të diktaturës, tashmë i stërlodhur nga intrigat dhe grackat e persekutoreve, për të gjetur ngushëllim tek familja, arkivat dhe pasionin për korifejtë e letrave shqipe e botërore. Puna si arkivist në Arkivën e Shtetit e ndihmoi të qartësonte gjithçka në kozmosin e tij letrar dhe politik, teksta e vlerësosi të kaluarën si projektion për ardhmërinë, duke u thelluar në filozofinë e historisë së letërsisë dhe botëkuptimit bashkëkohësues të procesit krijues letrar e më gjerë...

Ai tashmë u shndërrua në mendimtarin dhe studiuesin e thellë, si dhe në shpërfilljen e vlerave njerëzore e letrare e kanalizoi kah një sistem vlerash krijuese e studimore, që më së fundi u kurorëzuan me dy veprat e tij të ripunuara monografike kushtuar Mjedës (Mjedjes) dhe Migjenit, të cilat sot i kemi të botuara me një cilësi të admirueshme, çka nderon studimet e thelluara në fjalë. Grafikisht, dy veprat lartësojnë përmbajtjen, goftë prej meritës së piktorit të famshëm Naxhi Bakalli që ilustroi tre kopertinat. Lartësim ky, goftë edhe për shkak të pasurisë fotografiko-dokumentare e arkivore, me të cilat autori mbathi dhe gatoi përmbajtjen.

Me të drejtë studiuesit vlerësojnë si tregues e niveleve të larta studimore të dy monografive, edhe vjeljen dhe ngjizjen konceptuale në veprë të një pasurie burimore faktologjike që përfshin shfrytëzimin e një literature prej 62 titujsh si bibliografi... Të dhëna këto autentike, e që në shumicën e tyre dalin në dritë për herë të parë. Po sipas studiuesve, skrupuloziteti dhe dashuria për personazhet të cilëve u

Ai shkëlqeu në kritikën e kohës

Ai shpërtheu në kritikën letrare të kohës me kompetencën, inteligjencën dhe pjekurinë e një njohësi, vëzhguesi dhe vlerësuesi të ditur e të drejtë. Përbuzte klishetë dhe qiçet në krijimtarinë letrare, pasoja këto të konformizmit, mungesës së kulturës, shablonizimit shpërbljes të mediokritetit dhe varfërisë metodologjike të zhdanovizmit të imponuar. Natyrshëm kultivoi dhe rriti frymën kritike dhe antikonformizmin në krijimtarinë dhe studimet letrare, çka ra në sy të vijërojtësve censurë, që e ndëshkuan bash në kulmin e fushatës që shpërtheu pas Plenumit IV të PPSH në vitin 1973.

blatoi veprën, e shtyu profesor Rinushin të hulumtojë e të kualifikojë mjeshtërisht të dhënat e rralla të marra deri edhe nga arkivat private në Shkodër e Vjenë. Pas punës së tij titanike dhe gjuhës së thuktë të një studiuesi që e njëj dhe e përdor si askush fjalën dhe semantikën e shqipes hyjnore (vërtet "Gjuhë perëndish"), kolosët e letrave shqipe na duken më të ndritshëm se kurrë e të brendësuar në gjuhën dhe zemrat e një populli që i deshi dhe i adhuroi. Thënë ndryshe, kësisoj, Rinush Idrizi solli dhe lartësoi në shpirtërat tanë përmendoret e dy prej baballarëve të kombit, të kulturës e qytetërimit tonë, me të cilët plot xhelozji kërkuan të rivalizojnë diktatorucët e despotët në kulturë dhe arte.

Kur krijuesit nuk i jepet ndonjë projekt-porosi, përzgjedhja që ai i bën personazhit të cilit i dedikohet, dëshmon formatin e njimentë krijues, botëkuptimin dhe rrugën në të cilën ai ka vendosur të rrugëtojë, me idealitet dhe vizionin që ai ka si yll polar. Dhe Rinush Idrizin e nderon dhe e lartëson përzgjedhja e tij. Por për shkak të përzgjedhjes në fjalë, ngaqë shpirti operon me botën transhendentale që beson dhe të cilës i përket, thuhet se ekziston një lidhje metafizike midis këtyre 3 personazheve, shprehur çuditshëm në raporte kohore: a) Më 1 gusht 1937 ndërroi jetë Ndre Mjeda (Mjedja); b) Plot një vit më pas, më 26 gusht 1938 ndërroi jetë Migjeni; c) Më 14 gusht 1938 lindi Rinush Idrizi, që ndërroi jetë më 17 tetor 2008; d) Ndërsa Migjeni lindi më 13 tetor 1911.

Po çfarë përfaqëson Rinush Idrizi si poet dhe çfarë ishte për të truallit letrar ku ai gjalloi dhe kulmoi? Poesia për të është hapësira ku shpirti i poetit lind... Dhe pasi poeti ndërroi jetë, ky shpirt shndërrohet në energji

artistike që endet në kozmosin letrar e kulturor duke bartur dhe përcjellë kodet dhe mesazhet e poetit në monologje të shprehura përjetësisht në gjuhë perëndish. E në ndodhtë që vargjet e poetit antikonformist e të censuruar të botohen ndonjë ditë, atëherë monologjet e dikursheve të tij me vetveten dhe unin poetik shndërrohen në dialog me lexuesin, që gjithmonë arrijn të zbulojnë shpirtin e poetit dhe shkaqet fundore të censurës prej pushtetesh okulte.

Por mosbotimi nga censura është një dramë e vërtetë për poetin e ndaluar, dhe një dramë të tillë e përjetoi edhe poeti e studiuesi Rinush Idrizi, teksta, edhe "për faj të tij-ndikimit", bash asokohe poetë të tjerë e përjetuan si tragjedi dhe e paguan edhe me jetë moskonformimin me diktaturën dhe parimet zhdanoviste në krijimtarinë letrare.

"Pakti i poetit me djallin e dëmtonte poezinë, kurse pakti i tij me ndërgjegjen për të mbetur vetvetja, ose i ndihnte censorët për ta shtyrë atë në theqafje humbëtrish shpesh pa kthim, ose e linte poezinë e tij në heshtjen e fshehtë", - shkruan bindshëm një studiues bashkëkohës me poetin. Poeti nuk mund të konformohet.

Poeti ose është vetvetja, ose nuk është poet. Ndaj dhe antikonformist-in Rinush Idrizi refuzuan ta botojnë në vitin 1963, kur dërgoi për botim një vëllim me poezi. E refuzuan pa droje, duke i thënë se ishte "larg realitetit të shkëlqyer socialist, ndaj dhe nuk e njihje dhe pasqyronte sa e si duhej në krijimtarinë poetike...". Por e vërteta qëndronte në faktin se ai refuzonte së brendshmi ta njihje dhe pranonte atë realitet të dhunshëm, që përthyej përgjakshtëm në sytë e shqyer dhe pezzat e shpirtit të tij.

"Rinushi nuk mendonte se ndonjëherë do t'ia botonin poezitë. Por ai, siç shprehej në një varg, varte në buzë një buzëqeshje për të fshehur trishtimin, dhe vazhdoje të shkruante në skeda, me stilografën e tij... Skeda ishte çarku i emocionit, i mendimit, i tharmit të tij poetik. Kurse stilografia ishte thepi i çarkut. Skeda ia përpinte fjalën, momentin, pasionin, dashurinë, kujtimet, heshtjen dhe ankthin e varrosur thellë", - shkruan studiuesja, që, mesa duket, e njëj me shumë se të gjithë ithtarin e përvuejtun të letërsisë. Por pavarësisht thëthitjes prej studimeve letrare, i imponuar nga magjia e tre kolosëve, Mjedës (Mjedjes), Migjenit dhe Poradecit, Rinush nuk mund të rrinte pa monologuar me vetveten dhe pa dialoguar me lexuesit e adhuruesit e shumë, si domos me nxënësit e gjimnazit "Sami Frashëri", ata të fshatit ku e degdisën kërcënueshëm, dhe me studentët e Gjuhë-letërsisë në Universitetin e Tiranës pas rrezimit të monizimit.

Me skedën dhe stilolapsin e tij ai

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e mirë. Nuk nisi me pretendime të mëdha, por shkrimi, në gjininë e dossier-it, që bëme për Ismail Qemalin dhe ideja e tij për Konfederatën Evropiane ia vlejti si shkrim kryesor. Duhet thënë se ka qenë një ide shumë revolucionare dhe kjo tregon jo thjesht staturën por edhe mendjen shumë pjellore dhe jo të zakonshme të burrit që firmoi pavarësinë shqiptare. Redaktori bashkoi dhe një pjesë fikshën të një autori të huaj, por përveç kësaj dhe një memorandum të Ismail Qemalit drejtuar sulltanit të kohës bashkë me gjërat e tjera. "Një politikë e dobishme për të tashmen e për të ardhmen- do të ishte prirja drejt vendosjes së një pakti midis shteteve ballkanike përmas arritjes së një aleance mbrojtëse dhe një marrëveshje ekonomike, prelude i kushtutës së një shteti të madh Oriental"-...i shkruan shqiptari i madh-Sulltanit...Një pjesë e shkrimit u botua dhe në Kosovë me citimin e vakët: marrë nga "Milosao".

Një përkthyes, e cila jeton në SHBA na solli një autore irakiane që jeton atje dhe tashmë po bën emrin e saj. Redaktori e vlerësoi dhe i la një vend të merituar. Trishtimi, që rrjedh nga poezia e saj dhe historia e tmerrshme e këtij vendi, bën bashkë trashëgiminë e një kulture të madhe por edhe fatalitetin e kohës, që e dërmoi këtë vend. Me shprehjet e kursyera ndërldhur me një figuracion shumë interesant vjen një copëz e madhe e inkohencës së këtij vendi, shkroi redaktori që vlerësoi dhe përkthyesen, të cilën e komplimentoi edhe për faktin se Mirela Petalli (Kapaj) kish marrë edhe copyright për botimin. Në fakt, poezitë tregojnë një autor

mesatare. Pikturit dhe akademikut Rexhep Ferri i botuam esenë e dytë, të quajtur "Plumbi i Lirisë", që na e kish sjellë bashkë me një botim tjetër, pak kohë më parë. Në formën e zakonshme erdhi ligjërimi i profesor Ferrit dhe mënyra si në kaleidoskop, që ai sheh strukturën mendore të shqiptarit të sotëm, por edhe mënyrën e tij të perceptimit. Fryma pesimiste i shkoi disi pasqyrimit të vërtetë të nënvetëdijes tonë kombëtare.... shkroi redaktori që ruan shumë respekt për piktorin e moshuar.

Vetë redaktori shtoi dhe një shkrim tjetër dhe ky ishte një argument që lidhej me Ulqinin e bukur, që përmytat turistikiest nga shqiptarë, malazezë, kosovarë dhe serbë, por që tashmë s'ka më librari dhe kjo është një betejë e dytë e humbur me librin. Beteja e parë është pengesat që i bëhen librit nga zyrtarët e rajonit sa i përket infrastrukturës së botimit. Mbase për këtë duhet të fasin mesvete zyrtarët dhe jo fjalët klike që thonë në çdo inaugurim...Pati reagime shumë të mira nga Ulqini dhe heshtje nga pala patetike shqiptare. Në fund iu la një vend dhe një reportazhi jo të zakonit për natyrën tonë për Policanin që autori u mundua dhe e përshatë në faqet e veta, por që duhej në fakt tek socialja... Në përgjithësi ishte numër jo i keq dhe i bërë... në momentet e fundit. Layout nuk ishte shumë i kujdeshëm dhe kurimi i fotos në faqen e parë dukej pak si shumë primitiv.

P

POEZIA

Autorja mëton se e ka shkruar poezinë në origjinal në finlandisht, porse është ndjerë e detyruar nga realitetet shqiptare ta përkthejë dhe në shqip...



Isha vrapuese!

NGA SILVANA BERKI

Gjithë jetës t'ime vetëm kam vrapuar...

si vajzë e vogël vrapova te ikja prej nenës,
e cila kërkonte që unë të rritesha para kohe,
Për fat, kisha prehrin e ngrohtë të gjyshes,
ku strukesha nganjëherë, si shiu mbas reshjeve të shumta.
Mbas dashurisë, kurrë nuk rrenda,
ishte e vetmja gjë mbas të cilës nuk vrapova kurrë,
e megjithatë edhe ajo më kapi gjatë vrapimit,
si gjuetari gahun e vet.
Kështuqë unë vazhdoja të vrapoja e të vrapoja edhe kur Shqipëria u rrëzua.
Nuk e di çfarë isha në atë kohë; lot apo pikë shiu të cilët fluturojnë vrapojnë dhe bien diku edhe pse muzgut ngjyrë gri,
edhe pse muzgut ngjyrë gri.
... ndërta tani jam këtu! Por as tani nuk e kam ndalur vrapin.
Unë vazhdoj të vrapoj duke i ikur vetes dhe juve,
duke i ikur paragjykimeve, emirave dhe fundja edhe vet Jezusit...
... gjatë vrapit jam rrëzuar sigurisht, e plagët më rridhnin nganjëherë gjak,
por rrugës, oh kësaj rruge,
vetëm aty e kuptova historinë time...

Isha vrapuese,
Kam qenë vrapuese e vetmuar,
madje edhe atëherë kur shiu më lagte e më bënte qull, unë vrapoja
madje edhe atëherë kur përballsha me stuhitë, unë vrapoja
madje edhe atëherë kur binte dëborë dhe këmbët e zbathura më dhimbin nga ftohja
unë vrapoja, e vrapoja, e vrapoja ...

Kam qenë vrapuese,
por, mos mendo se i tillë lind,
ti më krijove mua,
ti më krijove mua,
ti më krijove mua.

ndihej i lirë, thoshte dhe shkruante atë që ndiente, përjetonte ditën dhe natën, ndjenjën, dashurinë, buzëqeshjen, lotin, dhimbjen dhe vrazhdësinë. Shumë nga skedat e tij humbën kur dy shokët më të ngushtë ia arrestuan, ngaqë ata i asgjësuan para arrestimit. Pavarësisht dëshpërimit dhe dhimbjes që frymonte dhe ulërinte në vargjet dhe skedat e tij, si formë e rebelimit ndaj realitetit të papranueshëm, ai kundërvijei me dashurinë e pamatë për familjarët, nxënësit e shtrenjtë dhe miqtë. Dashuria e tij për nxënësit dhe studentët që mësonte, ishte plot dhimbje dhe i ngjante dashurisë së Migjenit për "Lulin e vocërr" dhe shokët e tij. E tillë ishte edhe dashuria e tij për miqtë e ngushtë, të cilët asokohe dhe sot përfaqësojnë fashën më elitare të shoqërisë shqiptare, teksa bëhet fjalë për të tillë si Naxhi Bakalli, Ilir Haxhir-exha, Robert Zhvarc, Perikli Jorgoni, Harallamb Qesko, Vaso Samsuri, Gavril Priftuli, Besnik Sopoti, etj..

Miq që kurrë nuk e tradhtuan poetin dhe atdhetarin e zjarrtë, studiuesin skrupuloz dhe polemistin e shkëlqyer që shndrrinte me forcën e argumentit dhe logjikën e pathyeshme.

Ata nuk u tutën nga rreziku që përfaqësonte uragani Rinush Idrizi, por e deshën fort dhe ia mësuam përmendësh poezitë dhe mendimet e krisura e me konotacion të fort politik dhe antizhdanovist. Rinush Idrizi ishte tejet i qartë në bindjet e tij profesionale dhe atdhetare. Ishte i palëkundur në to, pavarësisht studimeve të rrymave të shumta të mendimit dhe grackave logjike e epistemologjike që gëlonin në literaturën e ndalur dhe teoritë e mendimet që ai studioje, shkëmbente e debatonte me miqtë e bashkidealistët.

Si poet, studiues dhe intelektual atdhetar i angazhuar, në vitin 1991 Rinush Idrizi kontriboi si drejtuesi më i lartë i gazetave kombëtariste të djathta (gazetat "Kosova" dhe "Balli i Kombit"), ku krahas bashkëmen-



dimtarëve shkëlqeu me ide dhe teza që asokohe tmerruan politikanët injorantë të të dy kampeve. Të tilla ishin ato që u artikuluan qartazi dhe në momentin më crucial për zgjidhjen e Çështjes sonë Kombëtare dhe për rëndësinë madhore të faktorit shqiptar në Ballkan, si garantues i paqes dhe stabilitetit. Teza dhe qëndrime këto, që pasi u mallkuan dhe u shoqëruan me ndëshkime e luftë të paprincipitë ndaj autorëve, sot artikulohej paturpësisht me mburrje nga ndëshkuesit, duke mohuar autorësinë, pararendjen plot shkëlqim dhe kompetencën e atyre burrave menjdritur; në mes të të cilëve ish pozicionuar profesor Rinush Idrizi.

Por Rinush Idrizi dhe "takëmi" që e rrethonte, kishin qenë gjithnjë pararendës dhe kurrë "avangardistë-modistë dhe ekzibicionistë" të zhurmshëm, pa thelb e vepra, apo me kërrrenja gesharake përkohësie, që ranë bashkë me stinën e parë. Rinush Idrizi do të mbahet mend në letrat shqipe dhe do të mbetet në mendimin

filologjik, sociologjik e politik shqiptar si krijues tejet serioz dhe i peshës së rëndë, si mendimtar që shkëlqeu në udhëkryqet e historisë sonë të dhimbshme të fundshekullit të kaluar dhe të këtij fillimshekulli. Atij mund t'i adresohet meritueshëm përcaktimi "intelektual i brezit të humbur", ngaqë përpjekjet e tij e të bashkëmendimtarëve idealistë nuk u kurorëzuan, për shkak të rrethanave absurde në sfondin e një destini historik tragjik mbarëshqiptar.

Jo më kot shkrimin tim e titullova kësisoj, pasi huazova titullin që bashkudhëtarja dhe shoqja e jetës, studiuesja dhe kritikja e njohur, zonja Frida Idrizi, i ka vënë vëllimit poetik shoqërues me poezi të Rinushit, që u botuan nën kujdesin e saj krahas studimeve monografike kushtuar Mjedës dhe Migjenit. Në këtë përvjetor jubilar të lindjes, profesor Rinush Idrizi e meriton të përkujtohet plot nderime për gjithçka dha për vendin, qytetërimin dhe kulturën kombëtare.

P

POEZIA

Autori vjen me një cikël që përmbledh ndjenja nga melankolia, por edhe kujtimet e trishta të tij të dënimit dhe mbi të gjitha shndërrimin e njeriut të ri shqiptar...Autori është sa i këndshëm dhe i qetë në poezitë që e lidhin me traditën, aq i rreptë me ata që e lidhin me ditët tona. Forma e poezisë që ka zgjedhur, është shumë e thjeshtë.

NGA DAUT GUMENI

Këngë Pleqërishte

Kasollja me shtredhin m'udhë
S't'u nda lufta me kukudhë!

Kasollja e malit me drerë
Lerë që Zoti pa lerë!

Të qëllon fati me gurë
Rrebeshet s't'u ndanë kurrë!

E gurta kasolle stani
Ç't'i rrahu brinjët tufani!

Kasollja me kulm mbi re
Ndizje zjarrin me rrufe!

Kasollja e rrahur nga moti
Lerë që pa lerë Zoti!

Kasollja me kulm në qjell
E malluara për diell!

2018

Pleqtë e Progonatit

Pleqtë e Progonatit
Rritur nëpër brinja,
E bardha e qylahut
U kullon në thinja.

Pleqtë e Progonatit
Me krahë si shkaba,
Derdhen shkumë qumështi
Mëngoret e bardha.

Pleqtë e Progonatit
Të zgjedhur me dorë
Të rëndë e të heshtur
Si mallet me borë.

Pleqtë e Progonatit
Për rrapi mbështetur
S'e lëshojnë fjalën
Po s'që mirë e thekur.

Pleqtë e Progonatit
Male të thepisur,
S'e lëshojnë fjalën
Pa e cingarisur.

Pleqtë e Progonatit
Si shkëmbenjtë mugët,
Të varfër na lanë
Kur i morën rrugët!

Pleqtë e Progonatit
Nga mali shkëputur,
Na lanë ca fjalë
Më hije të bukur!

Pleqtë e Progonatit
U shuan ngadalë,
Qenë drita e fshatit
Na u bënë fjalë!...

2018

Spaçi i Harruar

Kampi i përqendrimit
në Spaç,
i dërrmuar nga dhimbja e shpërfillur
një anije e mbytur
në detin e harrimit.



Kampi të përqendrimit në Spaç i qenkan grabitur dhe kujtimet e vuajtjeve, si hekurat e ndryshkura e telat me gjemba të shitur për skrap që grabitësit e kujtimeve të vuajtjeve njerëzore të shtojnë fitimet!

Kampi i Përqendrimit në Spaç

ka ruajtur në gjë të malit vetëm galeritë e shembura që mbajnë fshehur plagët e rënda të para vetëm nga drita e kandilit të karbitit dhe nga zemrat e dhembura.

Kampi i Përqendrimit në brinjat e zhveshura të Spaçit, një anije e mbytur qëkuri në detin e harrimit. Në galeritë e shembura nga dhimbja që i shkaktoi njeriu- njeriut iu çanë Spaçit eshtrat prej guri, piko gjak të nxirë guri i Spaçit, plasi me dhimbje njerëzore guri i verbër i Spaçit kur pa si tjetërsohej burri!

2

Në shpatet harvallina të Spaçit paskan hapur galeri të reja për të nxjerrë nga mali mineralin e çmuar. Të burgosurit e dikurshëm politikë të përdorur si kuaj miniere i paskan harruar!

Ata të burgosurit politikë të pabindur që i shtynin për në punë të lidhur me hekura e përsëri të lidhur pas shtyllë në ballë të një galerie të verbuar nën borë e në mes të borës, i paskan harruar!

Ata të burgosurit politikë të dënuar edhe me punë skllavi,

ata që në turnin e natës detyroheshin të zhvishnin çizmet e gomës e me këmbët në pecet e lagura djerse të prisnin mbi borën e ngrirë, të prisnin cili do të merrte dënimin me natën e birucave dru e llamarinë të varura në hapësirë përmbi përroin në vërshim i paskan harruar!

Ata të burgosurit politikë që i varrosën përsëgjalli shembjet e malit në galeritë e thella në rropullitë e dheut ku mbahej mali me një cipal druri, ata të mbeturit pa varre që vetëm Përroi i Spaçit e di ku i ka shpurrë eshtrat e tyre, i paskan harruar!

Në rrepirat e roitura të Spaçit paskan hapur galeri të reja për t'i marrë malit mineralin e çmuar. Ata të burgosurit politikë që u ngritën në Revoltën e Majit dhe i zvarritën me tortura nëpër gjyqe, ata të dënuarit e ridënuar, ata të rebeluarit që u pushkatuan vetëm sepse liri kërkuan, i paskan harruar!

Kampi i Përqendrimit në Spaç i paska mbuluar me çakëll të murme ato rreketë ngjyrë-ndryshku, i paska mbuluar me pluhur guri edhe ato cërrat e holla ngjyrë gjaku të mpiksur. Kampi i Përqendrimit në Spaç qenka shembur nga dhimbja e shurdhuar e anijes së mbytur!

Kampi i Përqendrimit në brinjët e dala të Spaçit

i paska varrosur nën çakëll të murme dhe vuajtjet njerëzore nga dhuna, i paskan vjedhur dhe kujtimet e dhimbjeve si rrethimin me tela me gjemba e me karakollë përgjimi. Kampi i Përqendrimit në rrepirat e rrejpura të Spaçit shembëllen sot me një anije të mbytur me kohë në thellësitë pa dritë të detit të harrimit.

2018

Pa emër

Bëhen kot copa në luftë me kohën shërbëtorët shpinëthyer të shëmtimit, rropaten e rragaten si ata në përpëllitjet e dëshpëruara të gjarpërit në perëndim të diellit.

Bëhen copa kot në luftë me kohën shërbëtorët shpirtstërruar të shëmtimit, rragaten e rropaten si ata të gënjejnë dhe kohën si njerëzit këto krijesa gjuhustra të mashtërimit.

Shpirtshiturit shërbëtorë të shëmtimit tremben për vdekje nga dhimbjet njerëzore, për dhembshurinë njerëzore nuk kanë vend në zemër.

Shpirtshuarit shërbëtorë të shëmtimit tremben dhe nga vuajtjet e dashurisë, shërbëtorët kockësqullur të shëmtimit e humbin me turp luftën me kohën e mbeten mbi dhe si ato guaskat e zbrazëta që nxjerr vala në rërë, mbeten mbi dhe ca guaska të tharta pa shpirt e pa emër.

A

ARGUMENT

NGA QERIM VRIONI*

A shtu si nga të gjitha krahinat e vendit, edhe në minoritetin jugor grek, ka pasur regjistruar me aparatet e tyre njerëz, vende dhe ngjarje, të cilat mbeten me vlera dokumentare për kohën. Njeri nga këta është edhe Jorgo Vaso nga fshati Sotirë i Droupullit të Sipërm.

Ai është lindur në vitin 1903 në fshatin Sotirë të rrethit të Gjirokastrës. I ati, Mihali, si shumë bashkëkrahinarë, mërgoi në ShBA, ku edhe vdiq dy vite më vonë, kohë kur Jorgo ishte vetëm 13 vjeç. Për të përballuar kushtet e vështira ekonomike, pas një viti, djaloshi Jorgo shkoi në Stamboll, ku jetoi rreth shtatë vjet. Atje, ai mësoi mjeshtrinë e pasticërit dhe të...fotografit.

Më pas, më 1926, ai filloi punë si fotograf në Selanik (Greqi), një metropol i njohur historiko-kulturor ballkanik me banorë edhe nga të gjitha vendet e gadishullit. Pasi punoi dy vjet në Selanik, ku fitoi një përvojë të çmueshme, ai kthehet në fshatin e tij, ku edhe martohet me një bashkëfshatarë. Ndërkohë, vazhdon me fotografime në qytetet Gjirokastrë, Terpelenë, Përmet e krahina të tjera jugore. Duhet shënuar se punën e fotografit në fshatin e tij (Sotirë), Jorgo e kryen në kushte fare primitive (ndër të tjera, pa energji elektrike), me pak pajisje, por me shumë pasion. Prej kësaj ndërkohe kanë mbërritur në ditët e sotme shumë foto të bashkëfshatarëve të tij, të cilat flasin edhe për nivelin e qytetërimit të zonës së minoritetit jugor grek në Shqipëri.

Në vitin 1948, Jorgo Vaso vendoset në Sarandë, ku punon si fotograf në ndërmarrjen komunale për rreth 15 vjet, mandej del në pension po aty. Edhe pas kësaj shkëputje zyrtare nga puna, ai vazhdon të ushtrojë pasionin e tij, fotografimin deri në vitin 1977.

Pas disa vitesh, më 1985, ai vendoset në qytetin e Fierit, ku jetoi me familjen e të birit, Vasilit, deri në ndarjen nga jeta më 1996. Ashtu siç kishte kërkuar vet me gjallë, vendprehja e fundit e Jorgo Vasos u bë fshati i lindjes Sotirë.

Sipas të dhënave që disponon familja, ai ka lënë rreth 1000 filma (celuloidi) dhe një sasi të konsiderueshme në xhama, me foto njerëzish, vendesh, ngjarjesh dhe peizazhesh, shumica dërmuese e tyre ende e pa hedhur në letër.

Me krijimtarinë fotografike të Jorgo Vasos, është botuar në vitin 2007 në Tiranë, nga Ambasada Greke, një album me portrete të realizuara gjatë viteve 1920-1945. Përgjithësisht ato janë foto të porositura dhe me synime kujtimi a dokumenti të banorëve të fshatit të tij dhe të krahinës së Droupullit. Mjediset ku janë realizuar ato, janë të zakonshme, ndonjë dhomë shtëpije, lokal fshati, mur guri a tulle, të mbuluara me një tekstil të posaçëm si sfond etj. Fotot e albumit shpërfaqin jo vetëm tiparet kar-

Në këtë numër kemi historinë e veçantë të një fotografi minoritar, që e ka sjellë studiuesi i njohur...



Mali i Murgane, pasqyruar në liqenin e Pepelit-vitet '70

PËR JORGO VASO

Në vitin 1948, Jorgo Vaso vendoset në Sarandë, ku punon si fotograf në ndërmarrjen komunale për rreth 15 vjet, mandej del në pension po aty. Edhe pas kësaj shkëputje zyrtare nga puna, ai vazhdon të ushtrojë pasionin e tij, fotografimin deri në vitin 1977.

Pas disa vitesh, më 1985, ai vendoset në qytetin e Fierit, ku jetoi me familjen e të birit, Vasilit, deri në ndarjen nga jeta më 1996. Ashtu siç kishte kërkuar vet me gjallje, vënd-prehja e fundit e Jorgo Vasos u bë fshati i lindjes Sotirë.

Sipas të dhënave që disponon familja, ai ka lënë rreth 1000 filma (celuloidi) dhe një sasi të konsiderueshme në xhama, me foto njerëzish, vëndesh, ngjarjesh dhe peizazhesh, shumica dërmuese e tyre ende e pa hedhur në letër.



Jorgo Vaso-Stamboll, 1919

Historia e Jorgo Vasos, fotografit minoritar



Peizazh-Jorgo Vaso, vitet '40

akteristike të zonës, por në një farë mase, edhe mënyrën e tyre të jetesës, si psh, veshjet karakteristike dhe rite shoqërore si martesat dhe funerale. Vaso ka plotësuar rolin e fotokronikanit, jo vetëm për fshatin e tij, Sotirë, por edhe për fshatrat përreth, për ngjarjet e ndryshme shoqërore, fetare dhe ekonomike, *prurje* të cilat kur të hidhen në letër do jenë një ndihmesë e vyer për ata që studiojnë historinë e zhvillimit ekonomik-shoqëror të zonës.

Nga prurjet fotografike të Jorgo Vasos, të ofruara nga familja dallohen edhe dy peizazhe të qëlluara natyrore. Nga të dhënat e të afërmeve, mësohet se ato janë realizuar në jug të Shqipërisë, para vitit 1940.

Peizazhi i parë paraqet një liqen në sipërfaqen e të cilit pasqyrohet një mal që ndodhet pak largë. Në foto duken fare mirë planet e ndryshëm nga njeri-tjetri të dy imazheve, goftë të atij të vërtetë (fizik) ashtu edhe atij të reflektuarit në liqen.

Peizazhi tjetër paraqet një mal me borë dhe re sipër tij, poshtë tij duket një fshat dhe një lum. Imazhi ka kontraste të forta tonale dhe ka kuadrin mjaft të goditur e konfiguracion mbresëlënës. Realizimi i këtyre dy peizazheve (natyrisht ka edhe shumë të tjerë) tregon se Vaso, bënte edhe foto *për qeif*, pra pa porosi dhe pagesë. Po çfarë e ka shtyrë Vason që të përngrijë në foto këto pamje tërheqëse të natyrës? Do thoshim, asgjë përveç shpirtit të tij prej artisti që gjen shpërfaqje në lëmin e fotografisë. Të mos harrohet se fotografi ynë nuk kish ndonjë kualifikim të veçantë në fushë të dhomës së errët, pra ishte autodidakt.

Krejt e ndryshme nga të mësipërmet mbetet një foto e Jorgo Vasos, e cila të tërhiq vëmendjen është ajo ku paraqiten dy burra në klubin e fshatit duke tokur gotat e rakisë. Një ritual ky, sa i këndshëm për aktorët, aq i mbresëlënës për shikuesit e fotos. Ajo i takon vitit 1925, *pijetarët* (të themi janë miq të gotës) janë ulur pranë një tavoline të vogël rrethore, me gota po ashtu të vogla dhe me fare pak meze përpara, por burrat rrezatojnë një kënaqësi të përmbajtur (jo eufori alkoholike) para aparatit. Të gjitha gjerat në foto janë me *kursim*, përveç ëndjes serioze që rrezatojnë të dy burrat.

Njeri nga burrat ka veshje qyteti, ndërsa tjetri të zonës, mundet i dyti të ketë ftuar qytetarin për një gotë në klubin e fshatit, sa për të shkëmbyer dy-tri fjalë për të rejtat e situatës. Fotoja mendoj se e kalon cakun e një shkrepjeje rutinë dhe ka nuanca të *fotografisë shoqërore*.

Me sa është hulumtuar deri tani, pak foto të tilla, vërsnike të kësaj (para L2B), gjenden në FSH. Fotografi Kel Marubi ka me këtë temë, një të ngjashme me 23 dervishë, por duke gjerbur kafë, rreth viteve 1900-18.

Shumica e fotove janë hedhur në kompjuter dhe është në përfundim shfaqja aty e të gjithë arshivës fotografike që Vaso e kishte sistemuar dhe mirëmbajtur me kujdes. Gjithsesi, siç u përmend edhe më sipër, kur të *zbardhet* (hidhet në letër fotografike) pjesa më e madhe e krijimtarisë së begatë të Jorgo Vasos, të përzgjidhen prej saj ato më me vlerë, do dali më mirë dhe meritueshëm në pah puna e madhe plot pasion e kryer nga ai gjatë një periudhe rreth 60 vjeçare. Kështu, ai do zëri edhe vendin që i takon me të drejtë në Historinë e Fotografisë Shqiptare.

***Kritik fotografie**



Jorgo Vaso, Sarandë, vitet '70

Në klubin e fshatit, 1925



T

TREGIM

E ka zgjidhur shumë thjesht rrëfimin e tij autori...

ADAMI

NGA PRENG MACA

Ai e porositi dhe tani ishte i qetë, sepse kishte besim tek njeriu, i cili tashmë kishte marrë përsipër ta bënte sipas dëshirës së tij atë krijesë druri. (Kështu e kishte quajtur që në fillim ai atë.) Është njeriu i duhur, mendoi me vete. E donte shtatoren prej druri. Shkak ishte bërë vendosja e gjërave të tilla prej mermeri, guri, deri bronci, kudo në të gjitha lokalet që ngriheshin dhe druri përsos kësj ishte, si më me jetë. Gjithnjë kishte menduar, se nuk është kot ajo fabula e famshme e Pinokut e punuar me dru. Pastaj jeta e shfaqur në atë njeri gdhendur në dru.?

Lokali thuhet ishte i hapur. Ishin përdorur në atë lokal shumë lekë të fituara në emigracion, kishte aq shumë dashuri në atë. E mendonte shpesh, nëse lokali do ta meritonte gjithë atë mund e sakrificë të viteve me rradhë.

Lokalin e donte serioz, por në njëfarë mënyre donte që njerëzit të gjenin aty një mendim tjetër. Sipas atij, duhet t'a krijonte lokali, i cili ishte klasik, por brenda ngjyrave, ndriçimit kishte modernen, atë gjë që njeriu e ndjen, kur gjendet brenda aty, të gjendet edhe brenda vetes njëfarësoj...

Mezi e priste punën e porositorit. Duhet të jetë sa një femër normale, në këmbë, e të ngjallte atë gjë të veçantë e të fshhtë që zotëron femra në këtë botë: kureshtjen. Dua të jetë e veçantë. Bëje ti, si të mundesh. Unë besoj tek ti. Ata që më kanë rekomanduar për të ardhur tek janë miq, tek të cilët besoj e njëlloj dhe për ty është ky besim. Më kanë thënë, se ti bën gjithmonë gjëra... ekstra. Të tillë e dua. Lokali im quhet Eva. Kështu e kishte thënë njeriu, tek i cili e kishte porositor punën prej druri, Evën e tij prej druri.


Është femra që guxoi dhe ndoshta guximi i saj na bëri të jemi tani në, mëkatarë dhe të lumtur në të njëjtën kohë. Ky është pak a shumë qëndrimi im për jetën. Mendoj, se jeta fillon tek femra, tek guximi i saj për të qenë nënë, për të bërë burrin të mbajë përgjegjësinë e jetës. Ajo është strumbullari i kësaj bote. Shkaku i braktisjes së gjumit të zakonshëm, i aq ëndrrave, ëndrrallave dhe në fund, dua të jetë ajo dika në skaj të lokalit tim, siç është në mendjen time dhe të gjithë njerëzve në këtë botë. Nuk ka rëndësi nëse disa e pranojnë dhe disa syresh jo.

Ai e kishte dëgjuar qetë dhe pa debatuar më atë. I ishte dukur, se ai nuk ishte fare aty dhe nuk kishte lidhje fare me atë bisedë e punë, të cilën ai e kërkonte prej tij.

...Këto po mendonte, ndërsa hapte sërish sytë e tij të vëmendshëm, për të parë edhe njëherë diçka të fundit, të mundshme për të korrigjuar dhe....

-Eva, të lutem. Rregulloje pak atë perden... se nuk e duroj dot ashtu...-

-Po pranon- u përgjigj kamerierja e zgjedhur tashmë. Me një buzagaz të lehtë, shkoi tek vendi për të cilin u bë



vërejtja.

Tamam atëherë atij ju kujtua, se ajo quhej Roza. Pa dashje e kishte thirrur ndryshe. E kishte pushtuar ideja e asaj pune me dru. E priste me padurim dhe dashuri bashkë. E pa njëherë punonjësën e zgjedhur dhe për të njëmijten herë i shkoi në mendje ideja, se të gjitha femrat në njëfarë mënyre ishin Eva, ishin si të klonuara prej saj...Ndoshta, por çfarë rëndësie kishte kjo gjë tashmë. Rëndësi kishte lokali të shkente mirë dhe të justifikonte atë mund të madh.

Ajo punë me dru që ai e priste e kishte mprehur keqas. Ndoshta duhet të pushoj pak, mendoi ndërkohë. Kishte mbetur tani veçse një ditë në mes dhe ajo punë aq e dëshiruar prej tij do të ishte aty në vendin e vet. Mendoj, se si do ta zgjidhte dritën që do të binte mbi atë. E zhveshur thuhet, ajo do të ishte aty për të kujtuar të gjithëve, se janë në dorën e saj, në prehrin e saj, në dinakërinë e saj, të pranuar dhe të pa-pranuar.

Kontrolloi dhe njëherë për çelësin e makinës, hipi duke hapur derën, që kishte filluar të ankohej pak kur hapej dhe formoi, thuhet pa dashje numrin e telefonit të njeriut që do të punonte Evën, prej druri.

-Po -u gjejti tjetri nga ana tjetër... Thuhet se është gati. Do ta shohësh. Unë nuk di të flas por dhe është pa rëndësi, por jam i sigurt, se do ta bëj punën, si asnjë tjetër njeri. Unë e bëj, si më pëlgen mua. Vë veten time në atë gjë dhe jo për ta shitur. Eh, nuk ka rëndësi leku. Rëndësi ka t'ju pëlqejë. Nesër pasdite është aty. Do ta mbuloj. Do ta hapësh ti i pari. Natën.-

Kishte njëlloj pushteti dhe sigu-

rie në të folurën e tij. Kjo e qetësonte atë së tepërmi. Eh si do të jetë? E ndjeu veten, si përpara një takimi me një femër, një femër që të ndryshon jetën. I kaluan në mendje aq e aq vajza që i kishte dashur me zjarr e ca për të kaluar radhën e mashkullit, që i krijohet rastet nganjëherë një pas një. Disa syresh i kishte pasur dhe në shtratit e tij të rinisë që tashmë dukej, se po ja bënte me dorë. Të gjitha kishin diçka të përbashkët, por ai akoma nuk kishte arritur të gjente atë të veçantë që ta artikulonte, ta kishte të qartë në mendje. Ma hoqi mendjen me atë siguri, ai njeri. E kishte parë trupin e punuar në dru. I kishte pëlqyer shumë, por kokën ai nuk ja kishte lënë ta shihte.

"Është e imja", kishte këmbëngulur mjeshtri. Kishte prekur kokën e saj prej druri prej së cilës do të dilte fytyra e Evës, ëndërruar prej tij tash sa kohë...

...Mjeshtri kishte ardhur pasdite vonë. Kishte hyrë në lokal dhe kishte kërkuar të dilnin të gjithë jashtë sallës. Ata ishin bindur, sepse kjo ishte porosia e pranonit dhe nuk diskutohet. Vonë në pasdite ai kishte ikur. I kishte telefonuar pranonit të vinte e ta zbulonte vetë atë punë në dru, të kryer tashmë.

...Me një frymë ai eci dhe ndaloi makinën e tij para sheshit të vogël, ku mendonte të ishte parkingu i lokalit. I ngjiti shkallët me qetësi të shtirur, ndërsa ndjehej, si në ëndërr dhe i nervozuar lehtë në kureshtjen e tij të tundur. Lokali kishte një dritë, si prej dielli të vonë dhe një refleks tjetër dukej, sikur vinte prej një hënë të hershme qershori....

... Ajo ishte aty gati për ta hapur ai, i pari. Dhe ju kujtua ajo vajzë, që e kishte zhgënjyer në rininë e hershme. A jam i pari, e kishte pyetur ai. Jo, ishte përgjigjur ajo. Dhe i kishte treguar për atë lidhjen tjetër, me një shok klase. Nuk kishin qëndruar shumë kohë të lidhur bashkë.

Ishte ndarë shpejt me të. Nuk e duronte dot faktin, që nuk ishte i pari. I krijohej ideja, se do ta mbante gjithnjë në mes atë njeri, që kishte pasur lidhje me të dashurën përpara tij, vajzë të cilën ai e dëshoi si asnjë tjetër. E kishin gortuar shokët, por ai nuk ishte hapur më shumë. Kishte thënë, se nuk i ngjiste me atë dhe.... pikë.

Nuk e di, pse iu kujtua tamam kjo ngjarje tani, kur ishte përpara asaj Eve, prej druri, që ai e kishte porositorit. Ajo ishte e kryer aty pas asaj perdeje, e mbuluar në virgjërinë e saj. Iu duk një cast, si e gjallë. Një pjesë e saj e këmbës ishte e zbuluar lehtë dhe ai për pak tentoi ta mbulonte, por vetëm dora nuk iu bind. Ndjeu sërish t'i formohej në mendje mendimi, se femra ishte qenie... e cuditshme... Ishte i pari që do ta shihte dhe vetëm atë krijesë që e kishte torturuar për aq e aq ditë.

E hoqi ngadalë mbulesën. Trupi i hijshëm i Evës së punuar në dru ishte përpara tij, thuhet, merrte frymë. U dridh lehtë. I pëlqeu përtesa me të cilën i hidhte sytë tek fytyra e saj. Dëshoi ta shihte ngadalë, me një ide, se nuk kishte çfarë të ishte e veçantë më shumë, se ai trup i punuar në mënyrë të përsosur, si i gjallë. Dukej sikur mjeshtri, kishte futur frymën e vet aty.

Flihtëj se mjeshtri, kishte pasur një lidhje të përfolur shumë me një femër klasi, por nuk kishte ecur. Kishte mbetur me atë lidhje të përfolur e cila herë ndizej e herë dukej, se nuk do të merrte më frymë dhe tamam atëherë lidhja e tyre, riniste sërish. Por kjo është jeta e tij, mendoi me vete pranonit dhe u shtang, kur hodhi sytë e tij nga koka dhe pa....

Nuk e kishte menduar kurrë këtë. Vetëm këtë nuk e kishte menduar kurrë. O Zot!... Çfarë gjëje ishte aty në vend të kokës së Evës, prej së cilës sapo ai kishte menduar, se kishte ardhur çdo grua në këtë botë!....

Dhe ai kënd, me një dritë që ai kishte dashur t'i ngjante muzgut në të cilin lind diçka e

madhe...njeriu tek Eva.

Tashmë Eva ishte aty e përsosur, thuhet do të zbriste e do të merrej me të gjitha gjërat në botën e tij, me aq shpresa dhe ambicie për jetën. Dhe në vend të kokës ai kishte vendosur një...mollë. Ishte molla e guxuar prej Evës, që në rastin e parë ardhur në jetë, kafshimi i së cilës kishte bërë të ishte kjo botë mëkatarësh tashmë.

Ishte krejt i befasuar! Mori në telefon një mikun e tij që të pinte një kafe me të, për të ndarë më atë mik çudinë e lokalit të tij...dhe pastaj formoi numrin e mjeshtrit, që e kishte bërë atë mrekulli nga duart e shpirti i tij...por telefoni ishte i mbyllur.

Dje në "Reporter.al"

"Korrigjimi" i kufirit të Kosovës do të shkundte themelet e Europës

Nga Marcus Tanner

(vijon nga faqja 1)

... mes Kosovës dhe Serbisë, heshjtja e Bashkimit European dhe e Uashingtonit për këtë temë është ogurzë.

Ndarjet etnike të bazuara në plebishite të mbikëqyrura ishin një mënyrë normative për zgjidhjen e konflikteve kufitare pas Luftës së Parë Botërore.

Në atë botë shumë të ndryshme, krijimi i shteteve etnikisht të pastra shihej asokohe si zgjidhje. Perandoritë e vjetra dhe të mundura poliglote, Austro-Hungaria dhe Perandoria Osmane, ishin të dis-kredituara dhe karakteri i tyre shumetnik shihej si shkak kryesor i rënies së tyre.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Europa, Amerika dhe ish-Bashkimi Sovjetik pësuan një ndryshim radikal të mendjes. Ndarjet me bazë etnike u konsideruan si thellësisht të papëlgjeshme, si një rrezik për marrëveshjet e pasluftës, nxitje për revizionizmin dhe parimisht të gabuara.

Shtetet etnikisht "të pastra" lidheshin tanimë me projektin nazist, ndërkohë që multikulturalizmi po promovohesh si pasuri, jo si pengesë. Në vitet 1990, duke ndjekur shembullin e vendosur nga shpërbërja e Bashkimit Sovjetik, Europa dhe Shtetet e Bashkuara këmbëngulën që kufijtë e të gjitha shteteve që dalin nga ish-Jugosllavia duhet të ndjekin kufijtë e brendshëm të ish-republikave - ose të krahinës në rastin e Kosovës.

Nuk ishte i lejuar asnjë devijim apo "korrektim". Serbisë nuk iu lejua asnjë pretendim etnik për Krajinën në Kroaci apo në veriperëndim të Bosnjës. Njësoj, edhe Kroacia nuk mund të kishte pretendime për Hercegovinën në Perëndim, as Bosnja për Sanxhakun - e kështu me radhë.

Megjithatë, burime të informuara thonë se opinioni në Bruksel dhe Uashington në këtë parim dikur të paprekshëm mund të ndryshojë. Kjo shpjegon arsyen se pse nuk ka pasur dënime të bisedimeve në rritje mes Serbisë dhe Kosovës për ndarjen.

Një artikull i britanikes "The Guardian" këtë javë shkroi se burimet e saj thonë se "humori ndërkombëtar ndaj një ndarjeje të mundshme të Kosovës po ndryshonte, pavarësisht kundërshtimit të kancelares gjermane, Angela Merkel". Gazeta shtoi gjithashtu se kur ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić takoi dhëndrin dhe këshilltarin e Donald Trump, Jared Kushner në korrik, ata "diskutuan mbi ndarjen".

Ajo citon gjithashtu një burim nga qeveria serbe, ndërsa thotë: "pozicioni amerikan është duke ndryshuar, nga totalisht kundër



ndarjes në gatishmëri për ta diskutuar si opzion. Franca është gjithashtu mjaft pozitive për të. Gjermania nuk është".

Korrespondenti i "The Economist" për Ballkanin, Tim Judah, një bashkëpunëtor i hershëm i "BIRN", tha se pas vizitave në Serbi dhe Kosovë, ai kishte vënë re një ndryshim të theksit të ndarjes nga Brukseli dhe Uashingtoni.

"Përpara ishte një tabu dhe ata madje nuk donin që dikush të fliste për të. Por tani po thonë OK, ju diskutojnë dhe më pas e shohim".

Mjet i diskutuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve:

"Ndarja" u shfaq fillimisht në gjuhën e diplomacisë në fund të shekullit të 18-të, kur Rusia, Prusia dhe Austria e aplikuan atë brutalisht në Poloni, duke ndarë në mënyrë të vazhdueshme copat e mbretërisë së vjetër derisa nuk mbeti më asgjë. Por kulmi i vërtetë i ndarjeve ndoqi fundin e Luftës së Parë Botërore, kur nacionalizmi etnik gëzoi besueshmëri intelektuale dhe krijimi i shteteve etnikisht "të pastra" u trumbetua si çelësi i krijimit të një Europe më të qëndrueshme.

Ndarjet dhe plebishitet u aplikuan në zona të shumta. Irlanda u nda në vitin 1922, padyshim më shumë në linjat fetare sesa etnike, me gjashtë nga 32 vendet që mbetën në Britani. Schleswig-Holstein u nda në 1920 pas një referendumi, ndërkohë që në veri Schleswig u kthye [pas] në Danimarkë. Silesia e Sipërme u nda në vitet 1921-1922 mes Polonisë dhe Gjermanisë, gjithashtu me plebishit. Njësoj u nda dhe Burgenlandi mes Austrisë dhe Hungarisë, në ndjekje të një referendumi të mbajtur në Sopron/Odenburg në dhjetor 1921, ku qyteti i shkoi Hungarisë dhe pjesa tjetër Austrisë.

Carinthia shkoi gjithashtu për ndarje, për qëllim të cilës aleatët fitimtarë e ndanë atë në dy zona; zonën A dhe B. Referendumi e mbikëqyrura arritën në përfundim-

min që të dyja zonat t'i bashkoheshin Austrisë - nga zemërimi ndaj mbretërisë së re të serbëve, kroatëve dhe slovenëve.

Pas Luftës së Dytë Botërore, ndonëse ndarjet me bazë etnike e humbën pëlqyeshmërinë, u aplikuan në Istria, duke bërë që qyteti i Triestes të qëndronte në Itali, ndërsa pjesa tjetër e Istrias shkoi në Jugosllavinë. Një tjetër anomali kurioze ishte referendumi i mbajtur në Tende/Tenda dhe La Brigue/Briga, çka sollti që të dy fshatrat të kalonin nga Italia në Francë në vitin 1947.

Në Europën Lindore, Bashkimi Sovjetik urdhëroi Rumaninë të heqë dorë nga rajoni i Dobrukhës në Bullgari mbi baza etnike, ndërkohë që vetë Bashkimi Sovjetik i rregulloi kufijtë e vet në mënyrë drastike me Poloninë dhe më pak me Rumaninë, sërisht duke përmendur kriterin etnik.

Por klima intelektuale dhe diplomatike po ndryshonte me shpejtësi. Ideja e dikurshme "e kufijve etnikë", me ngjyrim të dukshëm nazist shihej tanimë si një qëllim prapanik. Për më tepër, aleatët ishin të vendosur të zhduknin atë që revizionizmin.

Kufijtë konsiderohen tanimë si të përhershëm, pavarësisht ndryshimeve të pakicave, një parim që pati pasojat të mëdha në Ballkan. Në mënyrë të modifikuar, kjo nënkuptonte që kur shtetet shpërbëheshin në mënyrë të pakthyeshme, siç bëri Jugosllavia, bota do të këmbëngulte që kufijtë e vjetër të brendshëm do të ktheheshin në kufijtë e rinj të jashtëm.

Ky parim avantazhoi disa komunitete më shumë se të tjerët. Pothuajse të gjithë maqedonasit dhe slovenët u lanë brenda kufijve të republikave të tyre respektive. Por lanë gjithashtu gjashtë milion kroatë jashtë Kroacisë, kryesisht në Bosnjë, dhe një numër edhe më të madh serbësh jashtë Serbisë - shumica dër-

rmuese e të cilëve sërisht në Bosnjë.

Si rezultat, nacionalistët maqedonas, slovakë dhe boshnjakë janë shumë konservativë në çështjen e kufirit; pak kanë aspirata serioze në drejtim të veriut të Greqisë, Carinthias dhe Sanxhakut, ndërkohë që serbët, dhe në një masë më të ulët kroatët, priren natyrshëm drejt revizionizmit.

Deri tani, ëndrra të tilla kanë mbetur thjesht ëndrra. Por nëse Europa dhe Shtetet e Bashkuara do hidhnin tutje rregullon dhe do të lejonin një "korrektim" kufijsh në baza etnike mes Serbisë dhe Kosovës, "precedenti i tmerrshëm" do të ishte, natyrisht i vendosur.

Në fund të fundit, nëse disa dhjetëra mijë serbë dhe shqiptarë në të dyja anët e kufirit aktual mund t'i ndryshojnë kufijtë e tyre, çfarë do t'i ndalonte rreth 1 milion serbët në Bosnjë?

Çështja e vogël gjeneron mosmarrëveshje të mëdha:

Popullatat në fjalë në kontekstin Kosovë-Serbi janë çuditërisht të vogla për një mosmarrëveshje të tillë të madhe. Në Kosovë, pavarësisht fjalimeve dorëlëshuara për "Veriun Serb të Kosovës", në realitet çështja prek tre komuna; Leposaviç [popullsia 18 600 në 2015], Zvečan [popullsia 16 650] dhe Zubin Potok [15 200] dhe gjysma e Mitrovicës. Zgjidhja e vetme domethënëse urbane është qyteti i drejtuar përgjysmë nga serbët e Mitrovicës, shtëpi për rreth 30 mijë njerëz.

Në të shumtën e vet, e gjithë zona banohet nga 80 mijë njerëz.

Në anën tjetër të kufirit, pothuajse e gjithë Presheva shqiptare banohet nga 35 mijë njerëz. Më shumë se gjysma e qytetit dhe e komunës së Bujanovcit janë gjithashtu shqiptarë, siç janë një përqindje më e vogël në Medvegje.

A mundet Serbia dhe Kosova të arrijnë një marrëveshje?

Edhe nëse marrin lejen ngur-

ruese të Europës për të thyer një parim kyç të marrëdhënieve ndërkombëtare të pasluftës, është e vështirë të shohësh arrijtjen e një marrëveshjeje nga të dyja palët në konflikt.

Më e rëndësishmja, të dyja vendet nuk janë të barabarta në forcën e negociatave.

Ky është një dallim i madh mes së tashmes dhe plebishiteve të 1920-1922, kur të dyja palët ishin të barabarta në fuqi - si Austria dhe Hungaria - ose kur në përballjen mes Gjermanisë dhe Danimarkës, Gjermania ishte një fuqi e humbur dhe jo në pozitën për të ushtruar presion.

Në kontekstin Kosovë-Serbi, në anën tjetër, Kosova është kërkuesja - kërkon njohjen e pavarësisë së saj nga Serbia.

Serbia e pavarur që prej Kongresit të Berlinit në 1878 nuk ka probleme të tilla mbi vendin e saj diplomatik në botë. Kosova ka nevojë për një marrëveshje, pra, më shumë se Serbia.

Karta e vetme e vërtetë e Kosovës - dhe nuk është një AS - është se mosmarrëveshja ngadalëson progresin e Serbisë drejt anëtarësimin në BE. Por Serbia mund të jetojë me këtë.

Nëse lideri i Serbisë, Aleksandar Vučić po shkon për ndarje, ai pothuajse me siguri do të kërkojë korrektime në favorin e Serbisë: Serbia të marrë komunat veriore që Kosova nuk i kontrollon - në këmbim të njohjes së pavarësisë së Kosovës.

Është e vështirë të imagjinosh Vučić, ose çdo lider tjetër të Serbisë, t'i ofrojë Kosovës një territor që e ka nën kontroll, vetëm për hir të "drejtësisë".

Një tjetër faktor i ndërlikuar është e ardhmja e serbëve që mbeten në Kosovë. Shpresa e tyre e vetme qëndron në formimin e vonë të një shoqate të komunave autonome të Serbisë në Kosovë. Por Kosova ka rezistuar mbi këtë çështje për vite me radhë, duke dashur ta mbajë këtë kartë rezervë dhe duke mos e lëshuar atë përpara një marrëveshjeje përfundimtare.

Megjithatë, nëse Kosova e vogël do të detyrohet të japë pjesë të rëndësishme nga toka e saj, shanset e krijimit të një shoqate të komunave autonome serbe në territorin e mbetur të saj janë gjithashtu minimale.

Shkurtime, komunitetet e vogla rurale serbe në jug do të merrnin fund, ndaj zëdhënësit e serbëve në Jug, të tillë si Sava Janjić janë kaq të ashpër kundër ndarjes.

Në të gjitha gjasat, pavarësisht se ç'lejojnë në parim Europa dhe Amerika, planet e ndryshme të "korrigjimit të kufijve" në mendjet e Vučić dhe Thaçit do të vazhdojnë të mbeten shumë larg për ta bërë të mundur një marrëveshje.

Opiniononi *i* Ditës

“Protesta” e ekonomisë reale

Nga Fatos Çoçoli

(*vljon nga faqja 1*)

... Ekonomia virtuale, ajo e dhjetëra mijëra vendeve të reja të punës, e 500 milionë dollarëve të futura në xhеп nga qytetarët me të ardhura të ulëta dhe të mesme, si rezultat i aplikimit mbi katër vjet e gjysmë (1 janar 2014-gusht 2018) të taksës progresive, e rritjes ekonomike të trefishuar në 5 vjet (2013-2017), po shkon më mirë sa më s'ka. Me gjithë shpirt, do të donim të ishte kështu. Edhe pse shifrat, të shkëputura nga realiteti dhe të para vetëm nga një përmasë, qëndrojnë, ato nuk tregojnë ekonominë e vërtetë të shqiptarëve. Ato 500 milionë dollarë më shumë që shohin shtetarët tanë nga aplikimi i taksës progresive, nuk janë futur aspak të gjitha në konsum. Përndryshe inflacioni do të kishte shkuar 3 dhe 4 për qind, me konsumin e rritur. Në të kundërt, në sektorë kyç të ekonomisë dhe të shërbimeve, sipërmarrësit flasin për konsum të vakët, madje edhe në ulje, në disa sektorë. Ekonomia jonë po i afrohet shtatorit 2018 me probleme të mëdha. Krija ekonomike, edhe kështu e trefishuar, gati 4 për qind, është anemike. Ajo nuk po jep vende të reja pune në nivele të mjaftueshme për të rritur konsumin. Borxhi publik nuk është ulur, sikundër u premtua, për vitet 2017-2018. Nëse llogarisim edhe pagesat e partneriteteve publik-privat, që ende nuk kontabilizohen në detyrime, pra borxhet e qeverisë, borxhi i bie të jetë rritur. Qeveria ka dhënë 712 milionë euro koncesion për katër boshte rrugore të reja. Sa mirë do të kishte qenë nëse këto para do t'i kishin kompanitë vendase që fituan koncesionet! Por ato nuk i kanë. Kapitali i tyre i deklaruar, i marrë së bashku, nuk është as sa një e njëzeta e vëllimit të punëve që kanë marrë përsipër. Sigurisht, në mjete ndërtime (makineri, makina etj.), këto kompani kanë më herë më shumë se miliona eurot e rirregjistruara. Por megjithatë, ndoshta të të dhjetat e parave që duhen për të ndërtaur këto akse



rrugore do të merren me kredi. Nuk dihet formula e saktë e rënë dakord në dhënie e koncesioneve, por për këto kredi, që do të merren nga bankat tregtare të vendit, do të dalë garant shteti ynë! Dhe këto para, rreth 600 milionë euro, do të merren nga stoku i parave të bankave tregtare, që normalisht duhet të shkojë për të kredituar sipërmarrjet dhe individët shqiptarë, që do të duan para kredi nga bankat. Pra, jo vetëm fut shtetin dhe paratë e të gjithëve për të garantuar kreditë e kompanive private vendase që u ke dhënë koncesionin, por edhe u heq riskun (të paktën një pjesë të mirë të tij) qytetarëve dhe kompanive të tjera private të këtij vendi, që të marrin kredi nga sistemi ynë bankar! Kjo

po që është me shumë probleme. Nga ana tjetër, dy investimet e huaja madhore, TAP-i dhe hidrocentrallet mbi Devoll, në vitin e ardhshëm përfundojnë. Bashkë me to edhe kamerdarja jonë e madhe e shpëtimit në ekonomi, investimet e huaja direkte. Me dollarin e forcuar nga rritja e interesave të bankës qendrore amerikane, Rezervës Federale, shumica e investimeve strategjike tani shkojnë për në SHBA. Për ne, në gadishullin tonë dhe në Ballkanin Jugperëndimor, do të ketë gjithnjë e më pak investues të rëndësishëm të interesuar. Të paktën për një periudhë 2-3 vjet sa do të vijojë rritja e normave të interesit të bankës qendrore amerikane dhe politika e dollarit tejet të fortë. Kjo duhet

të përbëjë një shqetësim të madh për qeverinë tonë dhe për vullmin e saj pas 1 shtatorit. Më 1 janar 2014, realisht, me rritjen 50 për qind të tatimit mbi fitimin, kemi humbur një pjesë të mirë të avantazheve tona krahasuese, në raport me konkurrentët tanë për investues të huaj, si Maqedonia dhe Mali i Zi. Duhet patjetër të vijmë në 1 janar 2019 me një politikë tjetër fiskale, me taksën e sheshtë, që të rrizgojmë interesin e investuesve të huaj. Tashmë rilindja e ekonomisë shqiptare shtator 2018-qershor 2021 kalon vetëm përmes një reforme të re fiskale, për të mundësuar ardhjen e investuesve të shumtë të huaj. Po kush do të protestojë, që të vijë kjo reformë?

HOROSKOPI

DASHI
Çështjet e parave mund t'ju shkaktojnë shumë stres sot. Planetet për të bërë një blerje mund të anulohen për mungesë fondesh. Duke u stresuar dhe duke u mërztur nuk arrini të mendoni në mënyrë të kthjellët.

DEMI
Një ditë e mrekullueshme për të bërë blerje, sepse dëshira për të ndjekur stilet e fundit të modës do të jetë e theksuar. Një ditë perfekte për ta kaluar nën shoqërinë e partnerit.

BINJAKET
Imaginatat tuaja duhet të fluturojë lart sot. Do t'ju lindë dëshira për të udhëtuar në vende ekzotike dhe për të njohur kulturat të reja. Mos lini pas dore një çështje pune e cila ka një afat.

GAFORJA
Ëndrrat tuaja në lidhje me paratë mund të bëhen realitet nëse kapni në kohë shansin. Vjet ju këshillojnë që të tregoheni më aktivë dhe të dëshmoni se vleni më shumë nga sa të tjerët mendojnë.

LUANI
Biseda me një mik tek i cili besoni shumë mund t'ju hapë sytë për mundësi të reja në karrierë. Këto mundësi kanë nevojë për shqyrtim të kujdesshëm, pasi nuk i keni menduar kurrë më parë.

VIRGJERESHA
Ëndrrat, zbulimet ose vizionet e çuditshme mund të përmbysin orientimin tuaj shpirtëror. Relaksoni në fillim mendjen pastaj trupin, duke menduar vetëm pozitivisht dhe duke bërë shëtitje në natyrë.

PESHORJA
Një mik të cilin nuk e keni parë për një kohë të gjatë mund të zgojë ndjenja të reja të çuditshme për të cilat jeni të papërgatitur. Ju mund ta shihni këtë person si një partner potencial romantik. Ndoshta nuk është një ide e mirë për të ndjekur këtë tërheqje sot.

AKREPI
Formimi i një partneriteti të ri biznesi mund të transformojë jetën tuaj. Përfitimt mund të mos duken për pak kohë, prandaj mos e lini punën që keni aktualisht. Sigurohuni që të njihni të gjitha faktet para se të bëni ndonjë angazhim formal.

SHIGJETARI
Disa detyra të papërfunduara mund të kenë nevojë për vëmendjen tuaj sot. Nëse jeni i angazhuar në sektorin e ekonomisë, gjërat do të shkojnë mjaft mirë. Investimet do të shpërblehen.

BRICJAPI
Do të keni një ndriçim përreth jush që do ju bëjë mjaft sensualë dhe tërheqës. Mos u habitni nëse tërhiqni shikime admiruese nga të huajt. Kjo është një ditë e shkëlqyer për të caktuar një mbrëmje vetëm me të dashurin.

UJORI
Do të keni një dëshirë të fuqishme për të pasur një partner në krah. Ky person mund të jetojë larg ose të jetë në një udhëtim, kështu që do të kënaqeni qoftë edhe me një telefonatë ose me email.

PESHQIT
Mos harxhoni kohën tuaj me njerëz që ju bezdisin. Është në dorën tuaj se me cilin njeri kaloni momente të rëndësishme, prandaj bëni zgjedhjen e duhur. Gjithashtu tregoni më shumë kujdes me shpenzimet.

BalkanWeb.com


AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- 1. Ferguson trainer.
6. Grand Prix
8. Eshhtë stacion beduinësh.
11. Një artikull jo për vegjetarian
12. Kujt i vjen... di të bëjë.
14. Kaçaturian kompozitor
16. Logot pa kufij
17. Parashtesë për vetë.
19. Aktorja protagoniste e Vertigo.
21. Ndezur në aparaturë.
23. Eshhtë si telefilm.
24. Ai i shtatë është kinemaja.
26. Eshhtë me shumë se kërkësë.
28. Cristiano bomber te Real Madrid.
29. Teket e grave.
31. Në krye të masave.
32. Shkon goja... nga nepsi.
33. Duken të gjata ato të pritjes.
35. Gjysmë bataku.

- 36. Eshhtë për medaljen e parë
37. Eshhtë kujdesi i babait.
39.... Maiden që këndojnë.
41. Një "bombë" tenistike.
42. Fillojnë mykjen
43. Janë këngëtarët si Jose Carreras
45. Eshhtë këngë e kënduar nga komiku
47. Lumë në Francë.
48. Piktori i Ura e Narrit.
49. Kapen në kufij

VERTIKAL

- 1. Në hyrje të ambientit
2. Neeson aktor.
3. Ente Sociale Rumune.
4. Ajo e zezë nënkpton arbitrin.
5. Kufizojnë stacionin.
6. Tremb fëmijët.
7. Jepet për t'u marrë.
8. Qytet japonez.
9. Eshhtë pemë
10. Janë tallësit.
13. Roberto trainer italian.
15. Freni këngëtare lirike.
18. Gjysmë totale.
20. Një si divan.
22. Tipare pa zë
23. Ulet në dhomën e lartë.
25. Moore aktor.
27. Qe bomber brazilian.
30. Ishte shpërthimi i Little Boy.
33. Carolina, e bukura e Belle epoqe.
34. Mbarojnë fare
35. Pullman aktor.
37. Eshhtë thëllimi
38. Meg aktore.
40. Ndërmarrje Industriale Rajonale.
41. Një lidhëz.
44. Kaluar në krye.
46. Fundi i Turandot.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Mund të hidhet te kiromanti
5. Teket e kafes.
8. D'istria e Helena Gjikkës
12. Smith filozof.
13. Kuke regjisor
14. Një pjesë e minoritetit.
15. Modulli i Neil Armstrong.
16. Mund të jenë qitjeje.
19. Markë pistolette.
20. Mbyllti fushatat.
21. Eshhtë dorëzim.
22. Eshhtë detar.
23. Fillojë ilustrimet.
24. Eshhtë hon.
25. Diftong në duel
27. Një pjesë e rifillimit.
28. Një që kuron karien.
31. Nnganjëherë duhen vënë mbi.
33. E egër dhe e fortë.

VERTIKAL


- 34. Janë thënie e famshme.
35. Janë trupa qjellorë të tillë.
37. Inicialet e Stone regjisor
38. Memoria në kompjuter
40. Në krye të trupave.
41. Mund të jenë diskografike.
44. Eshhtë e zakonshme për pushime
46. Skuadër greke.
47. Bel i Maupassant.
48. Eshhtë thesar.

VERTIKAL


- 1. E famshme ajo maqedonase.
2. Një zakon.
3. Bëjnë alarm me ar
4. Inicialet e Mallë regjisor
5. Mund të jetë telefonike
6. Ka dy faqe
7. Mund të jetë një cutter.
9. Në mes të dhomës.
10. Mbahet me bateri.
11. Përfshijnë edhe Haitin.
13. Denis i enëve me presion.
16. Paguhen për shërbime.
17. Janë ufo.
18. Ekstrete në tunel.
21. Një atentator vetëvrasës.
22. Markë cigaresh.
26. Arrihet duke mundur.
28. Jonathan, regjisor i Heshija e qengjave.
29. Eshhtë aparat me zorrë.
30. Pak servilizëm.
31. Kështu e ka syrin vigjilenti.
32. Fatih trainer turk.
34. ... Nostra me mafiozët.
36. Mbyllin punimet.
39. Ai i shenjtë është papa.
42. Kufizojnë në teknik.
43. Fillojnë panikun.
44. Fund tuneli.
45. Në krye të armatës.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

Sudoku grid with numbers 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

Solved Sudoku grid

Argëtim filozofik

- Nëse keni fatin në anën tuaj, mund të mbijetoni pa mendjen.
- Të gjitha familjet e lumtura janë të njëjta. Të gjitha të palumturat - në mënyra të veçanta.
- Kur dikush me përvojë takohet me dikë me para, së shpejti ai me përvojë do të ketë paratë, dhe ai që kishte paratë do të ketë përvojë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME Përgjigja e numrit të djeshëm

Cryptogram grid with letters and numbers

Word search grid with words like ARKANA, ASTRO, AMARA, etc.



Thënie të mënçura

- Njerëzit përcmojnë atë që s'e kuptojnë.
- Dhuratat e vogla ruajnë miqësinë. Të mëdhajat dashurinë.
- Interesi që më ngjall një gjë, më bën ta ndjek aq gjatë sa që përfundoj duke mbërritur në fund të saj dhe vë re se ajo nuk ia vlen të mundimin që i kushtova.

